



SHBA-të dhurojnë pajisje në ndihmë të reagimit ndaj fatkeqësive natyrore

Në mjediset e Komandës Mbështetëse është zhvilluar ceremonia e dhurimit të pajisjeve në ndihmë të fatkeqësive natyrore. Forcat e Armatosura të SHBA-së në Europë (USEUCOM), nëpërmjet ambasadës së tyre në Tiranë, i dorëzuan Komandës Mbështetëse, donacione me pajisje ndaj reagimit të fatkeqësive natyrore dhe rikuperimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019. Gjatë dhurimit të donacioneve pranë

kësaj komande, ishin të pranishëm shefi Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, zëvendës ambasadori Demian Smith, si dhe kolonel Eagel nga USEUCOM. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ilir Xhebechia si dhe zëvendës ambasadori i SHBA-së në Shqipëri, z. Demian Smith, si

dhe të ftuar të tjerë, panë nga afër ndihmat e ardhura për emergjencat civile dhe tërmetet. Pjesë e paketës së ndihmave ishin dhe pajisjet për akomodimin e afganëve. Gjeneralmajor Begaj falënderoi zëvendës ambasadorin dhe përfaqësuesit e USEUCOM për mbështetjen e pakufizuar që kanë dhënë dhe vijnë të japin në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm për Komandën Mbështetëse, por për të gjithë... » faqe 2



100-VJETORI I MARREDHENIEVE DIPLOMATIKE SHQIPERI-SHBA

Ministri Peleshi: Vlerat euroatlantike, destinacioni final i shqiptarëve



» faqe 3

Shqipëria, anëtar i 98-të i Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë, IHO

Falë rritjes së aftësive dhe kapaciteteve të Forcës Detare dhe mbështetjes së vyer të Norvegjisë, Shqipëria bëhet anëtar i 98-të i Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë, IHO. Pas një pune disavjeçare, kapitenët e anijeve kanë një pamje më të qartë të bregdetit shqiptar, çka rrit trafikun detar në ujërat tona. Tashmë hartat detare të prodhuara nga Shërbimi Hidrografik i Forcës Detare do të njihen zyrtarisht për cilësinë dhe standardet...



» faqe 3

Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, vizitë në Bazën Ajrore Farkë

Në Bazën Ajrore Farkë ekipi Amerikan, i kryesuar nga nënoficeri i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, kryekapter Mark A. Leonard zhvilloi një vizitë pune në kuadër të vlerësimit dhe vijimit të asistencës e mbështetjes së zhvillimit të trupës së nënoficerëve në Forcat e Armatosura. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja nga afër me arsimimin dhe trajnimin e trupës së nënoficerëve, kurrikulat dhe programet mësimore që zhvillohen në strukturat stërvitore të Forcës Ajrore. Ekipi i nënoficerëve amerikanë i shoqëruar nga ekipi i nënoficerëve të Forcave të Armatosura kryesuar...



» faqe 5

Kolonel Altin Gjetaj: QPR, qendra avangard e Forcave të Armatosura

Komandant Gjetaj, fillimisht ju uroj suksese në drejtimin e Qendrës së Personel-Rekrutimit, kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të RSH. Me interes për lexuesin e gazetës "Ushtria" do të ishte dhe një prezantim i shkurtër i formimit tuaj ushtarak. Si nisi rugëtimi juaj nën uniformën ushtarake? Rugëtimi në uniformë ushtarake ka filluesin e hershme në vitin 1983, kur fillova shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Janë plot 39 vite që mbaj këtë uniformë në detyra e funksione të ndryshme, në disa rrethe të vendit, si Kukës, Pukë, Shkodër, Krujë, Durrës e tani në Tiranë...



» faqe 3

NDIHMAT E ARDHURA PËR EMERGJENCAT CIVILE DHE TËRMETET

SHBA-të dhurojnë pajisje në ndihmë të reagimit ndaj fatkeqësive natyrore

Bashkëpunimet

Shtabi i PËRGJITHSHËM



Forcat e Armatosura të SHBA-së në Europë (USEUCOM), nëpërmjet ambasadës së tyre në Tiranë, i dorëzuan Komandës Mbështetëse, donacione me pajisje ndaj reagimit të fatkeqësive natyrore dhe rikuperimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

Në mjediset e Komandës Mbështetëse është zhvilluar ceremonia e dhurimit të pajisjeve në ndihmë të fatkeqësive natyrore. Forcat e Armatosura të SHBA-së në Europë (USEUCOM), nëpërmjet ambasadës së tyre në Tiranë, i dorëzuan Komandës Mbështetëse, donacione me pajisje ndaj reagimit të fatkeqësive natyrore dhe rikuperimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

Gjatë dhurimit të donacioneve pranë kësaj komande, ishin të pranishëm shefi Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, zëvendës ambasadori Demian Smith, si dhe kolonel Egel nga USEUCOM.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ilir Xhebexhia si dhe zëvendës ambasadori i SHBA-së



në Shqipëri, z. Demian Smith, si dhe të ftuar të tjerë, panë nga afër ndihmat e ardhura për emergjencat civile dhe tërmetet. Pjesë e paketës së ndihmave ishin dhe pajisjet për akomodimin e afganëve. Gjeneralmajor Begaj falënderoi zëvendës ambasadorin dhe përfaqësuesit e USEUCOM për mbështetjen e paku-fizuar që kanë dhënë dhe vijojnë të

japin në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm për Komandën Mbështetëse, por për të gjithë Forcat tona të Armatosura, duke theksuar se kjo paketë ndihmash do ndihmojë në rritjen e aftësive operacionale dhe reaguese në rastet e fatkeqësive natyrore.

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir

Xhebexhia, vlerësoi mbështetjen dhe asistencën që SHBA-të kanë dhënë në shumë fusha, por njëherësh SHBA-të, në mënyrë të vazhdueshme, kanë kontribuar në grante dhe projekte me vlera të konsiderueshme, që konsistojnë në mbështetje të komunitetit.

Nga ana e tij, zëvendës ambasadori i SHBA-së shprehu mirënjohje për Shqipërinë dhe popullin shqiptar, si një popull mikpritës ku me bujarinë e tyre hapën dyert për popullin afgan.



TAKIMI

Gjeneralmajor Bajram Begaj i akordon "Certifikatë Mirënjohje" nënkolonel Kevin Murphy-it

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, ka pritur në një takim kortezie Drejtorin e Programit të Bashkëpunimit të Gardës së New Jersey-it me FARSH, nënkolonel Kevin Murphy, me rastin e përfundimit të detyrës.

Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj vlerësoi kontributin dhe bashkëpunimin mes Gardës së New Jersey-it dhe FARSH si dhe rolin e veçantë që ka luajtur nënkolonel Murphy në forcimin e këtij bashkëpunimi.

Nga ana e tij edhe nënkolonel Murphy falënderoi SHSHPFA dhe Shtabin e Përgjithshëm për mbështetjen dhe



bashkëpunimin mes Gardës së New Jersey-it dhe FARSH.

Në përfundim të takimit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, i akordoi nënkolonel Murphy-it "Certifikatë Mirënjohje", me motivacionin: "Për mbështetjen e vazhdueshme dhe të gjithanshme ndaj Shqipërisë. Në njohje dhe vlerësim të punës së shkëlqyer dhe të jashtëzakonshme të tij, përkushtimit, angazhimit dhe mbështetjes ndaj Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Sistemit të Arsimit Ushtarak Shqiptar".

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

100-vjetori i marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-SHBA

Ministri Peleshi: Vlerat euroatlantike,
destinacioni final i shqiptarëve

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar për 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku i pranishëm ishte edhe ish-sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo. Ministri Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen që SHBA i ka dhënë vendit tonë në arritjet e mëdha veçanërisht për anëtarësimin e saj në NATO dhe pavarësinë e Kosovës.

Duke e vendosur fjalën e tij në kontekstin e situatës së krijuar në Ukrainë, ministri i Mbrojtjes u shpreh se: “ky 100-vjetor është një gur tjetër kilometrik shumë i rëndësishëm për të dy palët, në mënyrë të veçantë në një kohë kur themelet e sigurisë dhe të paqes në botë janë vënë në provë të vështirë për shkak të agresionit të egër dhe të pajustificuar të Rusisë ndaj popullit të pafajshëm të Ukrainës”.

“Në këtë 100-vjetor të vendosjes së marrëdhënieve tona diplomatike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shqipëria janë më afër se kurrë. Padyshim që ndihemi shumë krenarë që përfaqësohemi me dinjitet në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si ‘bashkëpunëmbajtës’ me vendin më të fuqishëm të globit, me vendin që për asnjë çast nuk reshti së mbrojturi interesin tonë kombëtar edhe në ditët më të errëta të historisë së



shqiptarëve. Ndihe mi krenarë dhe mirënjohës për vlerësimin që Shqipëria merr si një promovuese e palodhur e paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, përherë të brishtë ndaj influencave që tentojnë të përdorin etninë dhe fenë si elementë përçarës dhe destabilizues. Ne jemi të qartë dhe të hapur në qëndrimet tona dhe diplomacinë që promovojmë në rajon. Ballkani Perëndimor ka vetëm një destinacion: Bashkimin Europian dhe vlerat euroatlantike! E natyrisht, në këtë rrugë, inkurajues të palodhur kanë qenë dhe mbeten Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, - theksoi gjatë fjalës së tij, z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes garantoj se Shqipëria do të punojë bashkë me aleatin strategjik në mënyrë që dekada e re të jetë dekada e konsolidimit të demokracisë, sundimit të ligjit dhe e mirëqenies së të gjithë shqiptarëve.

Po ashtu, ministri Peleshi garantoj se Shqipëria do të jetë gati të përmbushë detyrimet që i takojnë si vend anëtar i NATO-s në çdo kohë, në çdo vendim që merret për të garantuar jetën, lirinë dhe mirëqenien e qytetarëve, duke vijuar edhe angazhimin në misionet jashtë vendit si në: Irak, Afganistan, detin Egje, Bosnje, Kosovë, Letoni, Sudan i Jugut, etj.

Shqipëria, anëtar i 98-të i
Organizatës Ndërkombëtare
të Hidrografisë, IHO

Falë rritjes së aftësive dhe kapaciteteve të Forcës Detare dhe mbështetjes së vyer të Norvegjisë, Shqipëria bëhet anëtar i 98-të i Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë, IHO. Pas një pune disavjeçare, kapitenët e anijeve kanë një pamje më të qartë të bregdetit shqiptar, çka rrit trafikun detar në ujërat tona. Tashmë hartat detare të prodhuara nga Shërbimi Hidrografik i Forcës Detare do të njihen zyrtarisht për cilësinë dhe standardet e tyre, njëlloj si ato të vendeve të tjera anëtare të IHO.



Samiti

Forca DETARE



Në samit u diskutua mbi objektivat kryesore si: zhvillimin e bashkëpunimit në fushën detare, analizimin e çështjeve detare europiane si dhe promovimin e pikëpamjeve detare në forumet vendimmarrëse.



Komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Samitin e Komandanteve të Forcave Detare të Europës (CHENS 2022) në Bukuresht, Rumani. Në këtë samit morën pjesë komandantët e forcave detare nga 24 shtete europiane, anëtarë të NATO-s dhe të Bashkimit Europian, si dhe komandanti i Forcave Detare të Aleancës (MARCOM) dhe komandanti i Forcave Detare Amerikane për Europën dhe Afrikën.

Në samit u diskutua mbi objektivat kryesore si: zhvillimin e bashkëpunimit në fushën detare, analizimin e çështjeve detare europiane si dhe promovimin e pikëpamjeve detare në forumet vendimmarrëse. Tema kryesore e "CHENS 2022" ishte optimizimi i komandim - kontrollit ndërmjet njësive detare në det. Ky samit për vitin 2022 u organizua nga Forca Detare e Rumanisë. Kundëradmiral Adnand Agastra gjatë ditëve të qëndrimit në Rumani pati takime dhe me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Rumani Ilir Tepelena, atasheun ushtarak në Rumani kolonel Leonard Çoku dhe ushtarakët shqiptarë me detyra në shtabet e NATO-s në Rumani.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Samitin e Komandantëve të Forcave Detare të Europës



FORCA DETARE

Tema kryesore e "CHENS 2022" ishte optimizimi i komandim - kontrollit ndërmjet njësive detare në det. Ky samit për vitin 2022 u organizua nga Forca Detare e Rumanisë.

Forca Ajrore vlerësohet me medalje në dy ekipet, meshkuj dhe femra në kampionatin e ping-pongut në rang FA

Në Garnizonin Rinas u zhvillua ceremonia e mbylljes së kampionatit të ping - pongut në rang të Forcave të Armatosura, ku Forca Ajrore mori pjesë me përfaqësues nga Shtabi i FAj së bashku me ekipet e meshkujve dhe të femrave.

Gjatë ditëve të kampionatit, lojtarët e Forcës Ajrore zhvilluan ndeshje ping-pongu në ekip dhe individuale duke u vlerësuar me certifikata dhe medalje në ndeshjet individuale.

Forca Ajrore u përfaqësua me dy ekiye, ekipi i meshkujve i përbërë nga nënkolonel Skerdilajd Zavalani, major Artan Vathi dhe major Albert Dervishi, i cili zuri vendin e dytë për meshkuj.



Ekipi i femrave përbëhej nga kapiten Esmeralda Kola dhe kapiten Dolorosa Bushi, e cila zuri vendin e tretë për femra.



Forca Detare rrëmben vendin e parë në ping-pong

Në Garnizonin Rinas u zhvillua ceremonia e mbylljes së kampionatit të pingpongut në rang të Forcave të Armatosura, ku Forca Detare mori pjesë me ekipet e meshkujve dhe të femrave.

Ekipi i Forcës Detare u rendit në vend të parë në përballjen individuale midis forcave.

Vendin e parë për femrat e fitoi majore Selvie Thana, ndërsa për meshkuj krye kapter Kastriot Hysa.



Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, vizitë në Bazën Ajrore Farkë

Në Bazën Ajrore Farkë ekipi Amerikan, i kryesuar nga nënoficeri i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, kryekapter Mark A. Leonard zhvilloi një vizitë pune në kuadër të vlerësimit dhe vijimit të asistencës e mbështetjes së zhvillimit të trupës së nënoficerëve në Forcat e Armatosura.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja nga afër me arsimimin dhe trajnimin e trupës së nënoficerëve, kurrikulat dhe programet mësimore që zhvillohen në strukturat stërvitore të Forcës Ajrore.

Ekipi i nënoficerëve amerikanë i shoqëruar nga ekipi i nënoficerëve të Forcave të Armatosura kryesuar nga krye kapteri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm Albert Koka, u mirëpritën fillimisht nga nënoficeri i Forcës Ajrore kapter Aida Guxha së bashku me nënoficerë të Bazës Ajrore Farkë, ku shkëmbyen mendime mbi bashkëpunimin për zhvillimin e nënoficerëve në të ardhmen.

Ekipi u prit nga komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata, i cili i njohu me misionin dhe detyrat e Bazës, përgatitjen e kandidatëve për pilotë helikopteri si dhe diskutuan mbi perspektivën e trajnimit të tyre të mëtejshëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kuadër të programit të trajnimit për pilotë helikopteri "Blackhawk", me të cilët do të pajisen Forcat Ajrore Shqiptare në të ardhmen.

Ekipi Amerikan shprehu vlerësimet për vijimin e bashkëpunimit ushtarak në të ardhmen.

AKTIVITETI

QAPU pret ekipin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it

Në kuadër të aktivitetit "ALB SPP2200108ICE Senior NCO Development", Komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve Bunavi, Nënkolonel Bujar Fejzo, priti ekipin e Nënoficerëve të lartë të GKNJ, të kryesuar nga Nënoficeri i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, kryekapter Mark A. Leonard.

Ekipi i GKNJ i shoqëruar nga Nënoficeri i QAPU, Kapter Sefedin Muka u njohën nga afër me Kurset Institucionale dhe Programet Stërvitore që zhvillohen në këtë Qendër, si dhe u diskutua për mënyrën e zhvillimit të procesit stërvitor. Më pas, ekipi i GKNJ ndoqi programin stërvitor që po zhvillohet me efektivat rekrut kandidat për ushtar/detar aktiv të Kursit të Stërvitjes Individuale Bazë.



"DITË E HAPUR"

Gjimnazet e zonës së Shkodrës, vizitë në Batalionin I të Këmbësorisë

Batalioni I i Këmbësorisë (b1k) ishte stacioni i radhës ku Forca Tokësore (FT), në bashkëpunim me Qendrën e Personel-Rekrutimit (QPR) dhe Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA (QKMBMMFA) organizoi dhe zhvilloi "Ditën e Hapur" me gjimnazet e zonës së Shkodrës. Nënkolonel Ali Mali, komandant i b1k, pasi u uroi mirëseardhjen të rinjve gjimnazistë i njohu ata shkurtimisht me misionin dhe detyrat që realizon ky repart i rëndësishëm i Forcës Tokësore për



zonën e veriut.

Më tej gjimnazistët ndoqën nga afër një sërë demonstrimesh të përgatitura nga efektivat e batalionit III të Këmbësorisë. Të rinjtë, ndoqën nga afër organizimin dhe zhvillimin e një ore përgatitje fizike, kjo kryesisht me rekrutët e rinj që po zhvillojnë kursin e Stërvitjes Individuale Bazë (SIB). Më tej, stacionet e ngritura stërvitore ishin ata të goditjes së objektit dhe çlirimit të pengjeve, veprimet alpinistike, luftimit trup me trup etj.

Pjesëmarrësit shuan kureshtjen e tyre duke u bërë edhe vetë pjesë e veprimeve në stacionet stërvitore, duke prekur nga afër mjetet dhe pajisjet në përdorim nga trupat e b1k. Nëpërmjet materialeve dhe broshurave të përgatitura nga QPR, gjimnazistët morën të gjithë informacionin e duhur, se si mund të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura.

Aktiviteti vijoi me vizitë në stendat e ekspozimit të pajisjeve, mjeteve dhe armatimit të b1k dhe u mbyll me një program artistik nga QKMBMMFA.

Stërvitjet

Stërvitja "Rinas 22"

Trupat e Policisë Ushtarake testuan aftësitë e tyre më të mira në stërvitjen "Rinas 22". Efektivët e kompanisë së dytë demonstrojnë nivel të lartë përgatitjeje edhe në kuadër të Task Forcës së Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë, një strukturë e NATO-s e aftë për t'u dislokuar kudo dhe kurdo, në kohë rekord.

Policia Ushtarake zhvillon stërvitjet "Rinas 22" dhe "Swift Response - 22"

"Swift Response - 22"

Toga e Parë e Kompanisë së Parë Operacionale në Policinë Ushtarake zhvillon stërvitjen "Swift Response - 22" përkrah vendeve aleate të NATO-s në Maqedoninë e Veriut. Ndër objektivat e kësaj stërvitje ishte rritja e aftësive profesionale dhe ndërveprimi me forcat aleate në kontrollin e perimetrit të jashtëm të bazës, në mbrojtjen e afërt, reagimin në rast sulmi, shoqërimin dhe sigurimin e kolonave ushtarake, marrjen në dorëzim dhe transportimin e robërve të luftës nga toka dhe ajri.

Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të stërvitjes shumëkombëshe "Defender Europe-22".



Karriera e Nënoficerit

Fillon Kursi i 73-të Fillestar i Nënoficerit në QAPN

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerit u hap kursi i 73-të Fillestar i Nënoficerit i përbërë nga 56 kursantë.

Synimi i këtij kursi është hedhja e bazave për karrierën e Nënoficerit, marrjen e njohurive teorike-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuar me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësinë dhe përgjegjësinë si drejtues grupi.

Pjesëmarrësit nga strukturat e Forcave të Armatosura që do të ndjekin kursin do të marrin njohuritë themelore prej një periudhe 5 javore.



Specialistët e Batalionit të Xhenios eliminojnë rrezikun e municionit të gjetur në Mengel, Elbasan

Pas përfundimit të operacionit, municioni i paplasur u transportua për në Batalionin e Xhenios, ku do të magazinohet deri në asgjësimin përfundimtar të tij.

Specialistët xhenierë të EOD të Batalionit të Xhenios ditën e sotme pas sinjalizimit për gjetjen e një predhe të paplasur artilerie thërrmuese të kalibrit 75 mm në zonën Mengel, Elbasan, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe pas kryerjes së vlerësimit të rastit, ndoqën procedurat për mënjanimin e rrezikut të municionit të evidentuar në këtë zonë.

Pas vlerësimit, u konstatua nga ana e ekipit si municion i prekshëm e i lëvizshëm, që nuk kërkon asgjësim në vend. Komanda Mbështetëse ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në vite duke shpalosur një kapacitet të vyer jo vetëm në shërbim të misionit të Forcave të Armatosura për pastrimin e asgjësimit e municioneve të paplasura, por edhe në shërbim të komunitetit për eliminimin e rreziqeve të municioneve të gjetura.





Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve
Anjeza Musollari

Komandant Gjetaj, fillimisht ju uroj suksese në drejtimin e Qendrës së Personel-Rekrutimit, kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të RSH. Me interes për lexuesin e gazetës "Ushtria" do të ishte dhe një prezantim i shkurtër i formimit tuaj ushtarak.

Si nisi rrugëtimi juaj nën uniformën ushtarake?

Rrugëtimi në uniformë ushtarake ka filluesin e hershme në vitin 1983, kur fillova shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Janë plot 39 vite që mbaj këtë uniformë në detyra e funksione të ndryshme, në disa rrethe të vendit, si Kukës, Pukë, Shkodër, Krujë, Durrës e tani në Tiranë.

Çfarë do të thotë për ju, të jesh pjesë e Forcave të Armatosura?

Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura është nder dhe krenari sepse nuk përfaqëson vetëm veten, por përfaqëson njëkohësisht një nga strukturat e rëndësishme të shtetit, ushtrinë/Forcën e Armatosur. Është privilegj qenia ushtarak i Forcave të Armatosura, por është njëkohësisht edhe përgjegjësi shumë e madhe.

Para pak kohësh ju jeni emëruar Komandant i Qendrës së Personel-Rekrutimit, por, prej vitesh jeni pjesë e kësaj strukture.

Kur e ka filluar aktivitetin Qendra e Personel-Rekrutimit?

Qendra e Personel-Rekrutimit është krijuar me urdhër të MM, nr. 98 datë 22.06.2007, që shënon edhe fillimin e aktivitetit të saj. Fillimisht nga krijimi i saj në 2007 deri në muajin mars 2010 kjo strukturë ka qenë në vartësi të Komandës Mbështetëse. Në strukturën e saj, kishte personel prej 32 vetash, si dhe 12 Qendra Rekrutim-Mobilizimi në qarqe. Nga muaji mars 2010, Qendra e Personel-Rekrutimit është në vartësi të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Struktura e QPR-së ka ndryshuar edhe në vitet 2010, 2012, 2014 si dhe në vitin 2017. Me ndryshimet që iu bënë strukturës së Qendrës së Personel-Rekrutimit në vitin 2017 (me urdhër të MM, nr. 43 datë 19.01.2017, i ndryshuar), në strukturën e saj u shtua Qendra e Rekrutim-Mobilizimit, në përbërje/vartësi të saj u shtuan sektorët: Sektori i Pritjes dhe Testimit & Sektori i Marketingut; Sektori Rekrutimit për Oficer, Ushtar, Rezervë për Forcat/Komandat; Sektori i Rekrutimit për Oficer, Ushtar, Rezervë në Qark/Rreth në 12 qarqe.

Cili është misioni i Qendrës së Personel-Rekrutimit?

Misioni i Qendrës së Personel-Rekrutimit është: Rekrutimi i kandidatëve për oficer dhe ushtar/detar aktiv, përpunimi, administrimi i dokumentacionit dhe të dhënave individuale të personelit ushtarak aktiv, në rezervë/lirim dhe atij civil, përpunimi i dokumentacionit për përkujdesje e përfutje suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim, evidentimin e burimeve njerëzore dhe materialeve që do të mobilizohen gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme.

Mbi bazën e këtij misioni janë të përcaktuara edhe detyrat kryesore të saj, ku ndër to është "Rekrutimi i kandidatëve për oficerë e ushtar/detar aktiv, sipas planeve të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm".

Çfarë shërbimesh ofron Qendra e Personel-Rekrutimit?

Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR) është struktura e vetme e Forcave të Armatosura që administron dhe përpunon dokumentacionin për përfutimin e të drejtave në fushën e pensione dhe të përfutjeve suplementare sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, "Për

QPR është struktura që mban korrespondencë, bashkëpunon dhe përpunon dokumentacion për përfutje suplementare me strukturat e tjera shtetërore, sidomos me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në qarqe, agjencitë rajonale në të gjithë vendin. Ky bashkëpunim është dhe në fushën e përpunimit të dokumentacionit për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

Intervistë me komandantin e Qendrës së Personel-Rekrutimit

Kolonel Altin Gjetaj: QPR, qendra avangard e Forcave të Armatosura



sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 793, datë 24.9.2010, "Për zbatimin e ligjit nr.10142, datë 15.5.2009", i ndryshuar, ligjet e tjera të fushës së përfutjeve sociale, pensione e SHDUA.

QPR është struktura që mban korrespondencë, bashkëpunon dhe përpunon dokumentacion për përfutje suplementare me strukturat e tjera shtetërore, sidomos me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në qarqe, agjencitë rajonale në të gjithë vendin. Ky bashkëpunim është dhe në fushën e përpunimit të dokumentacionit për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

Vlen të theksojmë se, nga data 01 maj 2022, Qendra e Personel-Rekrutimit çdo shërbim e kryen online, sipas VKM nr. 252, datë 29.4.2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbimofuese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre".

Si është rritur ndër vite struktura dhe objektivi i saj?

Nga krijimi në vitin 2007 deri sot, në përpunime misionin dhe detyrat e përcaktuara Qendra e Personel-Rekrutimit është rritur strukturat dhe është duke iu shtuar përgjegjësitë, detyrat, por është rritur edhe në personel.

Në vitin 2012 u bë përqendrimi i të gjithë dokumentacionit të ish-qendrave të rekrutim-

mobilizimit në qarqe, i dosjeve të ushtarakëve në rezervë të cilat administroheshin nga strukturat e FA-së, si dhe filloi përpunimin e të gjithë dokumentacionit për pensione dhe përfutje suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim.

Në periudhën 2010-2012 në bashkëpunim me kompaninë CUBIC, u bë e mundur ngritja dhe funksionimi i sistemit të automatizuar i të dhënave të personelit aktiv të FA-së.

Në vitin 2013 komisionet e karrierës e zhvilluan aktivitetin e tyre mbi bazën e të dhënave që përmbante sistemi i automatizuar, i cili në vijimësi është përmirësuar me elementë të tjerë shtesë.

Në vitin 2014 QPR bëri një marrëveshje me Postën Shqiptare, nëpërmjet të cilës ofrohen të gjitha shërbimet për qytetarët. Kjo bëri që të shmangej paraqitja e qytetarëve në institucion dhe shërbimi të ofrohej nëpërmjet postës. Ndërsa që nga janar 2020 e në vijim marrja e këtyre shërbimeve bëhet nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.

Cili është parimi i mobilizimit në FA?

Në kuptimin ligjor "Mobilizimi ushtarak" është detyrimi ligjor i shtetasit, person fizik e juridik, për të marrë pjesë ose për të siguruar plotësimin e njësisë e reparteve të strukturave ushtarake me personel, materiale, teknikë, kafshë, automjete e mjete të tjera të nevojshme, kur situata e kërkojnë. Më tej ligji përcakton: "Mobilizimi ushtarak në Republikën e Shqipërisë kryhet në kohë paqe ose në kohë lufte. Mobilizimi është i përgjithshëm ose i pjesshëm. Kriteret e vendosjes së gjendjes së mobilizimit dhe të çmobilizimit, të përgjithshëm ose të pjesshëm, përcaktohen me ligj. Mobilizimi ushtarak në kohë paqe planifikohet, organizohet e drejtohet në përpunime me synimet dhe përcaktimet në dokumentin

e politikës së mbrojtjes, të strategjisë së sigurimit dhe strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë, nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, komandat e forcave dhe ato të mbështetjes".

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 10.2.2016 "Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme", ka përcaktuar detyrime për komponentin rezervë, gjë që ka përcaktuar detyrime për institucione e struktura, përfshi edhe QPR-në.

Njëkohësisht, Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes (VKM nr. 628 datë 25.09.2019) ka përcaktuar se "Niveli i ambicies së FARSH-ve është i ndërtuar me kapacitetet e NATO-s, të cilat plotësojnë atë pjesë të kapaciteteve operacionale që vendi ynë nuk ka burime të mjaftueshme dhe mundësi për t'i zhvilluar". Në fund të pikës 4.4. të kreut IV "Sistemi i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë" të VKM nr. 628 datë 25.09.2019, përcaktohet se: "Numri i personelit të FARSH-ve do të jetë në vitin 2020: 8500 forca aktive dhe 2100 forca rezerviste (25% të forcave aktive)".

Shtyllat kryesore të punës së kësaj qendre, janë: Rekrutimi për ushtar/detar aktiv në Forcat e Armatosura, rekrutimi për oficer, studime ushtarake brenda e jashtë vendit, është porta hyrëse e FA-së; administrimi, menaxhimi e përditësimi i të dhënave në dosjet personale dhe në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore për të gjithë personelin ushtarak e civil në Forcat e Armatosura; përkujdesja ndaj ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe familjeve të tyre, ofrimin e shërbimeve të ndryshme në fushën e mbrojtjes dhe evidentimi i burimeve njerëzore e materiale për komponentin e rezervës.

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha të këtij institucioni?

Sfida e institucionit që drejtoj, për vitin 2022 është: reformimi i procesit të rekrutimit në FA, i cili synon rridhësimin e seksioneve të rekrutimit në qarqe, përmirësimin e strukturës së rekrutimit duke e kompletuar me personel ushtarak; vënien në funksion të një qendre të lëvizshme për pritjen/testimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv që do të bëjë lehtësimin e procedurave të rekrutimit; ndryshim të akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me rekrutimin në FA; si dhe përmirësimin e procedurave të marketingut.

Cila është qasja juaj për arritjen e objektivave të QPR-së?

Për arritjen e objektivave të QPR-së puna ka filluar, janë hartuar programe dhe procedurat e nevojshme për implementimin e ndryshimeve. Aktualisht jemi në përfundim të hartimit të akteve nënligjore për lehtësimin e procedurave të rekrutimit të kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv për periudhën nga data 12.09.2022-18.11.2022. Lehtësirat kanë të bëjnë me kriteret e rekrutimit, dokumentacionin e nevojshëm, si dhe procedurat e aplikimit dhe të testimit.

Si rekrutohen ushtarët aktiv?

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në

FA si ushtar/detar aktiv, do të aplikojnë online, në Qendrën e Personel-Rekrutimit ose në Seksionet e Rekrutimit në qarqe. Shtetasit shqiptarë për t'u rekrutuar ushtarë/detarë aktiv në FA duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjykim;
- të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- të ketë figurë të pastër morale;
- të mos jetë i deportuar për kryerje të veprave penale;
- të mos ketë probleme me drogën dhe alkoolin;
- të mos jetë kontingjent krimi dhe të mos jetë i evidentuar si i tillë nga organet ligj zbatuese;
- mosha për t'u rekrutuar është 18-27 vjeç, ndërsa për specialitetin mjekësi 18-32 vjeç;
- të ketë kryer arsimin minimalisht 9-vjeçar, brenda ose jashtë vendit;
- të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;
- të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;

- të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

Kandidatët për ushtarë/detarë aktiv në FA paraqesin këto dokumente për regjistrim:

- Kërkesë me shkrim;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Formulari i vetëdeklarimit;
- Dy fotografi të përmasave 4x6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- Fotokopje e noterizuar dëftesës/diplomës shkollës/universitetit;
- Fotokopje e dëshmisë, certifikatës për aftësitë profesionale, gjuhësore, etj. (nëse ka);
- Dokumenti i qendrës shëndetësore i lëshuar nga mjeku i familjes;
- Ekzaminimet mjekësore për agjent infektiv (Hepatit B, C, sifiliz, etj.), grupin e gjakut të lëshuar nga drejtoritë e shëndetit publik ose laborator mjekësor të licencuar për këto analiza;
- Vërtetimi nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti.

A kanë interes të rinjtë shqiptarë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura?

Referuar mbështetjes nga Ministri i Mbrojtjes dhe shefi Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për përmirësimin e pozitës të statusit të ushtarakut, vëmendja e qeverisë gjatë vitit 2022 është rritja e pagës në masën deri 30 % të saj.

Kjo ka sjelle dhe një qasje të re dhe interesim më të madh tek të rinjtë shqiptarë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

Cilat janë benefitet e të qenit pjesë e Forcave të Armatosura?

Punë e garantuar, pushim vjetor, angazhim në misione paqeruajtëse, arsimim brenda dhe jashtë vendit falas, sigurim shoqëror dhe shëndetësor, qira banese, trajtim me ushqim, etj.

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Finlanda dhe Suedia dorëzojnë aplikimet për t'u anëtarësuar në NATO

Finlanda dhe Suedia, dorëzuan njëkohësisht letrat e tyre zyrtare të aplikimit për t'u anëtarësuar në NATO në mëngjesin e të mërkurës të 18 majit 2022. Letrat iu dorëzuan Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg në selinë e Aleancës në Bruksel nga ambasadori finlandez në NATO Klaus Korhonen, dhe ambasadori suedez në NATO Axel Wernhoff. Z. Stoltenberg i mirëpriti ngrohtësisht kërkesat, “kjo është një ditë e mirë, në një moment kritik për sigurinë tonë”, -tha ai.

“Ambasadorë, i dashur Klaus, i dashur Axel, miq të dashur, kjo është një ditë e mirë, në një moment kritik për sigurinë tonë. Faleminderit shumë për dorëzimin e aplikimeve për anëtarësimin e Finlandës dhe Suedisë në NATO. Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë rrugën e tij. Ju të dy kombet e keni bërë zgjedhjen tuaj, pas proceseve të thella demokratike dhe unë mirëpres ngrohtësisht kërkesat e Finlandës dhe Suedisë për t'u anëtarësuar në NATO. Ju jeni partnerët tanë më të afërt dhe anëtarësimi juaj në NATO do të rriste sigurinë tonë të përbashkët”, -tha në fjalën e tij në një konferencë shtypi, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, para të pranishmëve dhe së bashku me Klaus Korhonen (ambasador i Finlandës i akredituar në NATO) dhe Axel Wernhoff (ambasador i Suedisë i akredituar në NATO).

“Aplikimet që keni bërë sot janë një hap historik. Aleatët tani do të shqyrtojnë hapat e ardhshëm në rrugën tuaj drejt NATO-s. Interesat e sigurisë së të gjithë aleatëve duhet të merren parasysh dhe ne jemi të vendosur të punojmë me të gjitha çështjet dhe të arrijmë në përfundime të shpejta”, -tha Stoltenberg dhe nënvizoi se “gjatë ditëve të fundit, ne kemi parë deklarata të shumta nga aleatët që angazhohen për sigurinë e Finlandës dhe Suedisë”. “NATO është tashmë vigjilente në rajonin e Detit Baltik dhe forcat e NATO-s dhe aleatëve do të vazhdojnë të përshtaten sipas nevojës, -tha ai, -nëse të gjithë aleatët bien dakord për rëndësinë e zgjerimit të NATO-s”, -theksoi Jens Stoltenberg. “Të gjithë jemi dakord që duhet të qëndrojmë së bashku dhe të gjithë jemi dakord se ky është një moment historik, të cilin duhet ta shfrytëzojmë”, -tha Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s.

Finlanda dhe Suedia aplikojnë për anëtarësim në NATO

“Aleanca ushtarake është e gatshme të shfrytëzojë momentin historik që në një proces të përshtetshëm të lejojë Finlandën dhe Suedinë të jenë pjesë e aleancës, pasi të dy vendet paraqitën kërkesat e tyre për anëtarësim. Por aplikimet zyrtare, të dorëzuara nga ambasadorët e Finlandës dhe Suedisë në NATO, vijnë mes paralajmërimeve të Rusisë se një veprim i tillë, nuk është i mirëpritur dhe se mund të pasohet me një kundërpërgjigje. Presidenti rus Vladimir Putin nga ana e tij ka kërkuar ndërprerjen e zgjerimit të aleancës pranë kufijve të Rusisë, ndërsa disa aleatë të NATO-s, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania, kanë dhënë tashmë shenja se janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje sigurie për Finlandën dhe Suedinë, nëse Rusia përpiket t'i provokojë, ose destabilizojë ato, gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës. Vendet përfitojnë nga garancia e sigurisë e nenit 5 të NATO-s, që thotë se çdo sulm ndaj një anëtarësi konsiderohet si një sulm ndaj të gjithë

Stoltenberg: Ky është një moment historik që duhet ta shfrytëzojmë



anëtarëve, pasi të përfundojë ratifikimi i aplikimeve, ndoshta pas disa muajsh”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

Ky veprim është një nga ndryshimet më të mëdha gjeopolitike që do të rishkruajë hartën e sigurisë së Europës. Kryeministri britanik Boris Johnson gjithashtu mirëpriti aplikimet. Në një postim në Twitter ai tha se ambiciet e tmerrshme të Putinit kanë transformuar vijat gjeopolitike të kontinentit të Europës. Procesi i shqyrtimit të kërkesës pritet të zgjasë rreth dy javë, megjithëse presidenti turk Recep Tayyip Erdogan ka shprehur rezervë rreth anëtarësimit të vendeve nordike. Erdogan deklaroi se nuk mund të lejojë anëtarësimin e tyre për shkak të mbështetjes që ai thotë se këto vende u japin militantëve kurdë dhe grupeve të tjera që Ankaraja thotë se kërcënojnë sigurinë e saj kombëtare. E nëse tejkalohen kundërshtimet e Turqisë dhe bisedimet e anëtarësimit shkojnë siç pritet, të dy vendet mund të bëhen anëtarë të NATO-s së shpejti.

Opinoni publik në Finlandë dhe Suedi ka ndryshuar qëndrim rreth anëtarësimit në NATO, që kur Rusia sulmoi Ukrainën më 24 shkurt. Finlanda dhe Suedia bashkëpunojnë shumë ngushtë me NATO-n. Të dy vendet kanë demokraci funksionale, forca të armatosura të mirë financuara dhe kontribuojnë në operacionet ushtarake të aleancës dhe misionin për kontrollin ajror.

Pas mbi 200 vitesh, Suedia heq dorë nga qëndrimi neutral ushtarak

Qeveria e Suedisë mori vendimin zyrtar të hënën, më 16 maj 2022 për të paraqitur kërkesën për anëtarësim në NATO, duke ndjekur hapat e fqinjët të saj Finlandës, në një lëvizje që do ta ndryshojë hartën gjeopolitike të Europës veriore. Vendimi i Suedisë për të bërë kërkesën për anëtarësim në NATO vjen pas më shumë se 200 vitesh të një qëndrimi neutral ushtarak, vendim që shqetësoi presidentin rus Vladimir Putin.

“Qeveria ka vendosur të informojë NATO-n se Suedia dëshiron të bëhet anëtare e aleancës”, -tha të hënën kryeministrja suedeze Magdalena Andersson. Njoftimi erdhi pas një debati në parlamentin suedez, ku pati një

mbështetje të madhe për anëtarësimin e vendit në NATO. Nga tetë partitë e Suedisë, vetëm dy parti më të vogla të majta e kundërshtuan qëndrimin e qeverisë. Menjëherë Shtetet e Bashkuara thanë se mirëpresin deklaratat e Finlandës dhe Suedisë mbi synimin e tyre për të kërkuar anëtarësimin në NATO. “Ne do t'i mbështesim fuqimisht kërkesat e tyre kur ato të paraqiten zyrtarisht në Bruksel, por Finlanda dhe Suedia janë partnerë të ngushtë dhe të vlerësuar të mbrojtjes për Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n”, -tha Sekretarja e Shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre. Nga ana tjetër diplomatët e lartë të NATO-s u takuan të dielën në Berlin për të diskutuar mbështetjen e mëtejshme për Ukrainën dhe planet e Finlandës dhe Suedisë për t'u anëtarësuar në aleancën më të madhe ushtarake në botë, e cila ka furnizuar Ukrainën me armë gjatë gjithë luftës. “Në takimin me aleatët në Berlin morën pjesë edhe ministrat e Jashtëm të Suedisë dhe Finlandës. Të dy vendet janë partnerë të ngushtë dhe të vlefshëm të NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara, dhe Uashingtoni do të mbështesë fuqimisht anëtarësimin e Suedisë dhe Finlandës në NATO, nëse ato zyrtarisht vendosin ta bëjnë këtë”, -tha Sekretari amerikan i Shtetit Antony Blinken atë ditë. Dhe vetëm të martën në mëngjes, më 17 maj, ministrja e Jashtme e Suedisë Ann Linde do të nënshkruante aplikimin që deklaronte se “vendi dëshiron të anëtarësohet në NATO”. Kjo lëvizje politike ushtarake shënoi kështu një hap zyrtar nga Stokholmi drejt bashkimit me aleancën ushtarake të NATO-s, duke i dhënë fund dekadave të neutralitetit ushtarak, pasi pushtimi rus i Ukrainës ndezi një evolucion dramatik në sigurinë dhe gjeopolitikën europiane. “Kemi arritur në një përfundim që është më i miri për Suedinë”, -tha ministrja Linde.

Ndërkohë Finlanda që ndan një kufi 1 300 kilometra të gjatë me Rusinë, vetëm para pak ditësh dhe pikërisht të dielën, më 15 maj 2022, do të njoftonte zyrtarisht synimin e saj për anëtarësim në NATO, edhe pse Presidenti rus Vladimir Putin tha se anëtarësimi i Finlandës në NATO do të ishte veprim i gabuar. Por megjithatë Presidenti i Finlandës foli me Putin para njoftimit zyrtar të anëtarësimit

dhe tha se ishte i befasuar nga qetësia me të cilën ai e priti lajmin për planin e Finlandës për t'u anëtarësuar në NATO. “Situata tani ka ndryshuar. Ne do të fillojmë procesin e anëtarësimit në NATO. Putini, gjithashtu konfirmoi se ai mendon se ky është një gabim. Por tha se “Nuk po ju kërcënojmë”. “Në përgjithësi, diskutimi ishte i qetë dhe i ftohtë”, -tha Presidenti i Finlandës, Sauli Niinistö. “Qëndrimi i tanishëm i Suedisë dhe Finlandës për të aplikuar për anëtarësim në NATO dhe përgjigjia nga aleatët që kjo të shqyrtohet dhe përmbushet menjëherë është një shenjë e qartë se NATO ka mësuar nga gabimet e saj politike”, -do të shprehej zëvendëskryeministrja e Ukrainës Olga Stefanishyna.

Aplikimi i Finlandës dhe Suedisë, përse i druhet Turqia anëtarësimit në NATO të vendeve nordike?

Vetëm disa orë pasi Finlanda dhe Suedia paraqitën kërkesën e tyre për anëtarësim në NATO, duhej marrë vendimi për të nisur procesin e anëtarësimit të nevojshëm për këtë qëllim u duk se Turqia e frenoi këtë plan dhe bllokoi vendimin. Turqia tha se kërkonte veton ndaj pranimit të dy vendeve. Që Suedia dhe Finlanda të jenë pjesë e aleancës ushtarake, të gjithë anëtarët e saj duhet të miratojnë anëtarësimin e tyre. Por Turqia ka ngritur shqetësimet e veta të sigurisë dhe ka bërë kërkesa për dy kandidatët për anëtarësim.

Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan nga ana e tij duket se po pengon përpjekjet e Suedisë dhe Finlandës, të cilat morën vendimin historik për të kërkuar hyrjen në NATO. Ai deklaroi se nuk mundet të lejojë anëtarësimin e tyre për shkak të mbështetjes që ai thotë se u japin militantëve kurdë dhe grupeve të tjera që Ankaraja thotë se kërcënojnë sigurinë e saj kombëtare. Në një fjalim drejtuar partisë së tij islamo-konservatore në pushtet, AKP, në Ankara, Erdogan riafirmoi qëndrimin e tij. Zgjerimi i NATO-s me këto dy anëtarë, për Turqinë ka lidhje me respektimin e ndjeshmërisë së saj, theksoi kreu i shtetit turk. Ai kritikoi Suedinë dhe Finlandën se duan të mos heqin dorë nga mbështetja e tyre për “organizatat terroriste” në të ardhmen. Ai përsëri kritikoi Suedinë për refuzi-

min e ekstradimit të “terroristëve” dhe vuri në dukje: “NATO është një aleancë sigurie, një organizatë sigurie. Në këtë kuptim, nuk mund t'i themi po bërjes së pasigurt të këtij organi të sigurisë”.

Turqia, vendi që ka ushtrinë e dytë për nga madhësia në NATO, ka qenë tradicionalisht në mbështetje të zgjerimit të NATO-s, me besimin se politika e dyerve të hapura forcon sigurinë europiane. Turqia është shprehur p.sh. në favor të një perspektive anëtarësimi për Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Kundërshtitë e presidentit turk Erdogan për Suedinë dhe Finlandën burojnë nga pakënaqësitë e Turqisë me Stokholmin, dhe më pak me Helsinkin, për mbështetjen që mendon se i jep Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), e shpallur e jashtëligjshme në Turqi, si dhe grupit të majtë ekstremist DHKP-C, dhe mbështetësve të klerikut mysliman me qëndrim në Shtetet e Bashkuara, Fethullah Gulen, për të cilin Ankaraja thotë se orkestron puçin e dështuar ushtarak në vitin 2016. Shumë kurdë dhe azilantë të tjerë kanë gjetur strehë në Suedi gjatë dekadave të fundit. Atyre iu janë shtuar rishtazi edhe anëtarët e lëvizjes Gulen. Duke justifikuar kundërshtimin e tij, presidenti Erdogan thotë se vendi i tij nuk duhet të bëjë përsëri “gabimin” që bëri Ankaraja kur ra dakord të ripranohej Greqia në strukturën ushtarake të NATO-s, në vitin 1980. Ai thotë se kjo i mundësoi Greqisë “të mbante një qëndrim kundër Turqisë” me mbështetjen e NATO-s. Nga ana tjetër Turqia kërkon të bëhet sërish pjesë e programit të avionëve ushtarakë F-35 që udhëhiqet nga SHBA. Ajo u përjashtua nga programi pasi bleu sisteme ruse të mbrojtjes me raketa S-400. Nëse nuk bëhet dot pjesë e programit për avionët F-35, Turqia dëshiron të blejë një seri të re avionësh luftarakë F-16 për të përmirësuar forcat e saj ajrore. Kërkesat e tjera mund të përfshijnë dhënien fund të një embargoje jozyrtare ndaj armatimeve që aleatët i shesin Turqisë; koncesione nga vendet anëtare të BE-së për aplikimin e pasuksesshëm të Turqisë për anëtarësim; si dhe fonde të mëtejshme për ta ndihmuar vendin që të mbështesë 3.7 milionë refugjatët sirianë.

Por Turqia nga ana tjetër gjithashtu ka krijuar një imazh të mirë duke furnizuar Ukrainën me dronët luftarakë “Bayraktar TB2”, të cilët u bënë një armë efikase kundër forcave ruse dhe kjo lëvizje do ta cenonte këtë imazh. Dhe Turqia gjithashtu ka krijuar marrëdhënie të ngushta me Rusinë dhe me Ukrainën dhe është përpjekur t'i ruajë të balancuara këto lidhje. Turqia nuk i është bashkuar sanksioneve ndaj Rusisë, ndërkohë që e mbështet Ukrainën me dronët që ia ndaluan Rusisë të fitojë superioritetin në ajër.

Ndërkohë Aleanca e NATO-s nuk ka komentuar mbi diskutimet brenda Këshillit të NATO-s lidhur mbi shqetësimet e Turqisë. Por Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, nga ana e tij ka thënë se është i vendosur për të arritur një zgjidhje të shpejtë për Finlandën dhe Suedinë. “Këto dy vende janë partnerët tanë më të ngushtë dhe bashkimi me NATO-n do të rriste sigurinë euro-atlantike,” -tha ai.

Këshilli i Punëve të Jashtme të BE-së

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s diskuton mbi mbështetjen ushtarake për Ukrainën

Më 17 maj 2022, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoană, mori pjesë në një takim të Këshillit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Europian në konfigurimin e tij të mbrojtjes. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm dhe ministrat e BE-së

shkëmbyen mendime mbi agresionin rus kundër Ukrainës dhe diskutuan mënyra shtesë për të mbështetur më tej Ukrainën, duke përfshirë dhënien e ndihmës ushtarake.

Ministri i Mbrojtjes i Ukrainës, Oleksiy Reznikov, iu bashkua takimit përmes videokonferencës.



NDËRTIMI I DIXHITALIZIMIT GLOBAL

Konferenca e parë Ndërkombëtare mbi Diplomacinë Kibernetike

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm mban fjalën kryesore

Më 17 maj 2022, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană mbajti një fjalim hapës në Konferencën e parë Ndërkombëtare mbi Diplomacinë Kibernetike të organizuar nga Instituti Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim në Informatikë - ICI Bukuresht, në partneritet me Ministrinë e Punëve të Jashtme Rumune. Në fjalimin e tij, ai vlerësoi kontributet e çmuara që Rumania ka dhënë për Aleancën dhe mënyrën se si vendi ka zbatuar me zell premtimin e NATO-s për mbrojtjen kibernetike.

Duke folur për mbrojtjen kibernetike të NATO-s, ai tha se “me rritjen e varësisë tonë së përditshme nga asetet dixhitale, po ashtu rritet edhe cenueshmëria jonë ndaj sulmeve kibernetike dhe incidenteve”, duke nënvizuar rëndësinë e përfundimit të mbrojtjes kibernetike dhe qëndrueshmërisë në të gjitha nivelet. Kjo u demonstrua së fundmi në Ukrainë, ku “NATO ka ndihmuar në rritjen e qëndrueshmërisë së Ukrainës ndaj sulmeve kibernetike, si pjesë e mënyrës sonë për të mbështetur reformën e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë”, -vazhdoi zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Ai kujtoi iniciativat e shumta që NATO ka nisur për të forcuar mbrojtjen kibernetike të Aleancës, duke filluar me krijimin e hapësirës kibernetike një domen operacional krahas tokës dhe detit në vitin 2016. Kjo u pasua nga një politikë e re gjithëpërfshirëse e mbrojtjes kibernetike në qershor 2021, duke pranuar se hapësira kibernetike është e kontestuar në të gjitha kohët. Këto komente hapën edicionin e parë të Konferencës Ndërkombëtare për Diplomacinë Kibernetike, me titull “Ndërtimi i dixhitalizimit global: krijimi i besimit dhe sigurisë përmes diplomacisë kibernetike”. Veprimtaria mblodhi së bashku ambasadorë, akademi dhe ekspertë nga komuniteti ndërkombëtar kibernetik dhe i mbrojtjes dhe synonte të promovonte përsosmërinë në kërkimin dhe inovacionin në Rumani dhe ta integronte atë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në kërkimin kibernetik.



RRITJA E QASJES NDAJ MBROJTJES KIBERNETIKE

Takimi i parë i koordinatorëve kombëtarë kibernetikë të NATO-s

Koordinatorët e lartë kibernetikë nga të gjithë vendet aleate të NATO-s u takuan për herë të parë, në Bruksel, më 18 maj 2022. Ata diskutuan mjedisin e ri strategjik pas pushtimit rus të Ukrainës dhe implikimet e tij në peizazhin e kërcënimit kibernetik. Ata gjithashtu rishikuan progresin në fushën e mbrojtjes kibernetike, duke përfshirë përpjekjet për të rritur qëndrueshmërinë ndaj kërcënimeve kibernetike.

“Takimi i sotëm i Këshillit të Atlantikut të Veriut i koordinatorëve të lartë kibernetikë ishte një hap i rëndësishëm në rrugën drejt Samitit të NATO-s në Madrid”, -tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoană. “Ekziston një nevojë urgjente për të rritur qasjen tonë ndaj mbrojtjes kibernetike dhe kjo përpjekje kolektive nënkupton gjithashtu angazhimin me partnerët tanë, duke përfshirë edhe sektorin privat.”

Aleatët kanë shprehur shqetësimin se kërcënimet kibernetike ndaj sigurisë së Aleancës janë komplekse, shkatërruese, shtrënguese dhe bëhen gjithnjë e më të shpeshta. NATO është një platformë e fortë për të shkëmbyer informacione, për të shkëmbyer qasje dhe përgjigje kombëtare, si dhe për të marrë në konsideratë përgjigjet e mundshme kolektive. Aleatët po ofrojnë gjithashtu mbështetje praktike për partnerët, duke përfshirë Ukrainën.

Në Samitin e Madridit muajin e ardhshëm, aleatët do të marrin vendime të mëtejshme për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës. Mbrojtja kibernetike luan një rol kyç dhe kjo pritet të reflektohet në Konceptin e ardhshëm Strategjik të NATO-s.

Grupi transportues amerikan, anija sulmuese amfibe vendoset nën komandën e NATO-s

NATO fillon aktivitetin e vigjilencës “Neptune Shield 2022”

Grupi sulmues i aeroplanmbajtës “USS Harry S. Truman” dhe anije të tjera detare të SHBA-së janë nën komandën e NATO-s si pjesë e një serie stërvitjesh të mëdha ushtarake në detet Baltik, Adriatik dhe Mesdhe.

Në Mesdhe, grupi i transportuesve amerikanë është vënë nën komandën e NATO-s për herë të dytë këtë vit për stërvitjen “Mburoja e Neptunit 2022”, e cila do të zhvillohet nga 17-30 maj. Ky shënon vetëm transferimin e dytë të një grupi transportues amerikan në NATO që nga fundi i Luftës së Ftohtë.

Grupi Amfib i Gatishëm Kearsarge është vendosur gjithashtu nën komandën e NATO-s dhe aktualisht po operon në Detin Baltik për një seri stërvitjesh me aleatët dhe partnerët e NATO-s.

Oeiras, Portugali – NATO po kryen aktivitetin e vigjilencës “Neptune Shield 2022” (NESH22), i cili integron aftësitë e nivelit të lartë të goditjes ekspeditare detare të aseteve detare, ajrore dhe tokësore. Aktivitetet do të zhvillohen në detet Baltik, Adriatik dhe Mesdhe, nga 17-31 maj.

Në mbështetje të Komandës së Forcave të Përbashkëta aleate Brunssum dhe Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli, NESH 22 është faza e ekzekutimit të një serie të gjatë aktivitetesh të njohura si “Projekti Neptun”, i konceptuar në vitin 2020.

Si një aktivitet i përditshëm, NESH 22 do të përfshijë pjesëmarrjen e shumë kombeve. Vendet pjesëmarrëse tashmë të planifikuara janë: Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Spanja, Turqia, MB dhe SHBA.

Aktiviteti përqendrohet në kapërcimin e kompleksitetit të integritetit të komandës dhe kontrollit të një grupi sulmues transportues, një grupi gati amfib dhe një njësie ekspeditash marine në NATO.

“Gjatë NESH 22, ne do të kryejmë dorëzimin e komandës dhe kontrollit të “USS Harry S. Truman Carrier Strike Group” (CSG) dhe Kombinuar Task Force 61/2, e cila përfshin “USS Kearsarge Amfibious Ready Group” (ARG) dhe 22d Njësia e Ekspeditës Detare (MEU) nga SIXTHFLT në STRIKFORNATO dhe në Aleancën më të gjerë”.

Gjenerali Tod D. Wolters, Komandanti, Komanda Supreme e Aleatëve për Europë (SACEUR) pret me padurim ekzekutimin e NESH22 duke iu referuar atij si një themelim i unitetit për të cilin NATO përpiket në të gjithë Aleancën. Gjenerali Wolters shton: “Aktivitetet e vigjilencës si NESH22 forcojnë aftësinë tonë për të integruar pa probleme aftësitë e goditjes detare për të mbështetur parandalimin dhe mbrojtjen. Ne vazhdojmë të bëjmë gjithçka që është e nevojshme për të mbrojtur Aleancën.”

Aktivitetet e Vigjilencës janë një linjë bazë, ose aktivitete normale të përditshme, që ndodhin në të gjitha fushat dhe në të gjithë Zonën e Përgjegjësisë së SACEUR për të siguruar ndërgjegjësimin e duhur strategjik dhe gatishmërinë e forcës që kërkohet për të mbështetur paqen.

“NESH22 është një mundësi e shkëlqyer për përmirësimin e kapacitetit për të koordinuar me aleatët në vigjilencën e vazhdueshme në mënyrë që të stërvitemi për operacione shumëfushë dhe të përbashkëta të NATO-s,” -tha komandanti i Komandës te Forcave të Përbashkëta Aleate Brunssum, Gjenerali Jörg Vollmer. “Angazhimi i NATO-s për të promovuar paqen dhe sigurinë në zonën euro-atlantike shprehet qartë nga integrimi i aftësisë së forcave tona për të reaguar me shpejtësi në një kohë krize”.

Fjala korrupsion buron nga fjala Latine ‘corruptus’. Kuptimi i saj në shqip mund të jepet si ‘prishje e plotë’ e diçkaje. Corruptus në greqishten e vjetër përkthehet ‘fthóra’. Fthóra sërish merr shumë kuptime; disa prej tyre janë: zvetënim, prishje, kalbje, degradim etj. Për Aristotelin koncepti i ‘fthóra-s’, te “On Generation and Corruption”, vendoset përballë lindjes, d.m.th. ajo do të thotë ‘vdekja’ e një qenieje.

Korrupsioni vret, denigron, përbalt ndërgjegjen tënde! **Ndal!**

ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

Winston Churchill theksonte: “Korrupsioni shërben si vaj lubrifikues për makinerinë e demokracisë”. Shtetari i madh britanik, me alternim të mençur, dinte të distilonte retorikën për momentet e vështira dhe cinizmin për ato më pak të vështira. Korrupsioni, sidomos ai politik, zbriti poshtë në origjinën e njerëzimit dhe gjeti terren pjellor në Romën e lashtë. Dhe me Romë të lashtë nënkuptojmë si atë republikane, ashtu edhe atë perandorake.

Akoma më pak njihet korrupsioni në Romë përpara shekullit të III-të: jo sepse ai nuk ekzistonte, por thjeshtë sepse mungojnë tekste dhe dëshmi edhe indirekte lidhur me fenomenin. Kur në fakt arrijmë në prodhimin e parë letrar, rreth vitit 200 ku shfaqen referime ndaj korrupsionit dhe imoralitetit, si në aspektin privat, ashtu edhe në atë publik.

Fjala korrupsion buron nga fjala Latine ‘corruptus’. Kuptimi i saj në shqip mund të jepet si ‘prishje e plotë’ e diçkaje. Corruptus në greqishten e vjetër përkthehet ‘fthóra’. Fthóra sërish merr shumë kuptime; disa prej tyre janë: zvetënim, prishje, kalbje, degradim etj. Për Aristotelin koncepti i ‘fthóra-s’, te “On Generation and Corruption”, vendoset përballë lindjes, d.m.th. ajo do të thotë ‘vdekja’ e një qenieje. Por në politikë, Aristoteli me të njëjtin term kuptonte ‘devijantin’ ose ‘shmangësin’ nga një detyrë ose objektiv i paracaktuar. Aristoteli e lidh korrupsionin drejtpërdrejt me ndershmërinë dhe pushtetin. Sipas tij, “ndryshimi midis ndershmërisë dhe korrupsionit është se të jesh i korruptuar do të thotë të kesh pushtet të pakufizuar mbi një pronë ndërsa të jesh i ndershem do të thotë qeverisja e një shteti sipas nevojave të njerëzve”. Më tej, ai humton imanencën (brendaqenësinë) e korrupsionit me pushtetin. Sipas tij, ‘korrupsioni politik nuk është cilësi e individit, një e vetë natyrale, por karakteristikë e pushtetit, e çdo lloj pushteti, dhe pasojë e ofiqeve.

Në botën moderne, dhe kryesisht në kampin e “demokracisë” parlamentare dhe kapitalizmit, që tashmë ka marrë karakter global, korrupsioni lidhet më shumë me braktisjen e interesit publik në emër të interesit privat. Përqendrimi i pushtetit dhe ndershmëria nuk përmenden! Në anën tjetër, tradita marksiste, siç tregon Robert Mayer-i në një studim me mjaft interes, nuk shqetësohet shumë për shkakun e korrupsionit. Ndryshe nga Marksi, Lenini shqetësohet shumë për korrupsionin e ‘masave’.

Përparimi i lëvizjes kërcënohej nga korrupsioni i udhëheqësve të saj dhe qoftë edhe anëtarët e zakonshëm, burimi i atij korrupsioni që është i shoqërisë borgjeze dhe pasurisë së saj. Marksi dhe Lenini nuk mohuan

kapitalizmin sepse ai ishte në mënyrë të pashpresë i korruptuar, por ata besonin se ai duhet të ushtronte një influencë korruptuese mbi lëvizjen e cila kërkoi të transformonte shoqërinë borgjeze. Për republikanët termi korrupsion është ndër përshkruesit më emblematicë të shekullit të 21-të, menjëherë pas zbulimeve teknologjike. Fatkeqësisht, një fenomen i tillë është krimbi i cili ha trungun nga brenda. Meqenëse korrupsioni si fenomen bën vetëm rishpërndarjen (dhe jo krijimin) e vlerave, të krijuara brenda një shoqërie, tek të pasurit dhe rrethi i tyre, fatkeqësisht mbi barrën e më të varfërve që paraqesin një shumicë.

Nuk ka as edhe një shtet të vetëm në botë, i cili nuk përballet me cilëndo nga format e korrupsionit në një dozë të caktuar, ku kjo shumë thjeshtë mbështetet nga fakti se mbi 6 miliardë njerëz në botë jetojnë në vende të cilat kanë probleme serioze me korrupsionin (Transparency International, 2015).

Kur dikush flet mbi korrupsionin, fatkeqësisht ne kemi në mendje vetëm termat si ‘vjedhje’, ‘shpëlarje parash’ ose forma të tjera të ngjashme më të përhapura të tij.

Nëse korrupsionin e limitojmë vetëm në këto trajta të shfaqjes së tij, atëherë ne nuk mund të gjejmë zgjidhje për korrupsionin sepse nuk e kemi definuar akoma mirë atë si problem.

Edhe pse de jure ekzistojnë një mori ligjesh të cilat definojnë sanksionet për korrupsion apo edhe shumë shkelje tjera, thënia se “Rregullat janë bërë për tu thyer”, ka zënë një vend dominant.

Arsyeja pse ekziston perceptim kaq i lartë për korrupsionin, është sepse janë shumë të dukshme frytet e hidhura të tij, korrupsioni është shumë më shumë se sa ajo çfarë ne kuptojmë me termin ‘korrupsion tradicional’. Ai në një farë mënyre degëzohet duke i prekur së pari të gjitha institucionet, komunitetet e pastaj edhe neve si individë, duke u shfaqur në trajta të ndryshme.

Korrupsioni, pra efektet e tij i ka edhe në formë të papunësisë, burokracisë, konkurrencës jo të drejtë në treg, e cila rrjedhimisht destimulon hyrjen e bizneseve të reja por edhe operimin e atyre ekzistuese, mungesës së cilësisë së shërbimeve publike qofshin ato në shëndetësi, kulturë, arsim, infrastrukturë etj; vjedhje, pandershmëri, humbje të pasurisë publike, shfrytëzim, mashtrim, skandal, neglizhencë e përgjegjësi etj. Të gjitha këto së bashku sjellin situatën aktuale jo të kënaqshme shoqërore, të cilat në rrënjët e tyre si shkaktar kanë korrupsionin. Pra, ajo se çfarë ne duhet të arrijmë të kuptojmë është se korrupsioni nuk është si efekt anësor i papunësisë apo problemeve tjera me të cilat po ballafaqohemi si shoqëri, por përkundrazi është shkaktori rrënjësor i këtyre problemeve.

Përdërisa ka shumë institucione që luftojnë korrupsionin, sfida kryesore mbetet bashkimi i përpjekjeve për ta luftuar atë, bashkëpunimi në mes të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në luftën kundër korrupsionit, një sërë nismash anti-korrupsion, përgjegjëshmëria institucionale dhe integriteti në vend janë në zhvillim e sipër.

Fenomeni i korrupsionit është një ndër më shqetësuesit në shoqërinë mbarë globale. Duke shfrytëzuar terrenin e një shoqërie demokratike, ky virus e zhyt shoqërinë duke mos e lejuar të kapërcejë në trampolinat e zhvillimit human e demokratik.

Është e rëndësishme të kuptuarit mirë të këtij definicioni, sepse në shumë raste mund të anashkalohet kuptimi i tij i vërtetë, duke u deformuar e duke marrë trajta të tjera, kjo për arsye se ka një prirje nga ana e publikut shqiptar që të përfshijë në konceptin e “korrupsionit” edhe dukuri të cilat nuk janë të tilla. Për të analizuar sjelljen e shoqërisë karshi këtij problemi duhen pasur parasysh disa situata, të cilat çojnë në një tjetër tezë: “Sa te varur jemi ne nga korrupsioni”? Kjo nënkupton se shpeshherë ne jemi viktimat apo inicializuesit e tij?

Duke u bazuar në një sondazh të vitit 2019, kur gjykojnë të dy palët e përfshira në një transaksion korruptiv, shqiptarët tregohen më tolerantë kundërt “dhënësve” të ryshfetit dhe më të ashpër kundërt “marrësve”. Një nxënësi i cili i jep një dhuratë mësuesit të tij me shpresën se do të marrë një notë më të mirë është vlerësuar ose i pa korruptuar (35.4%) ose i justifikuar (34.7%). Pjesa dërrmuese, që janë viktimat të korrupsionit, qëndrojnë indiferentë, duke refuzuar t’i japin zgjidhje këtij problemi të vjetër sa vetë njerëzimi. Arsyeja kryesore që ky fenomen ka ekzistuar dhe është akoma i pranishëm në shoqëri është se shkaqet që çojnë në zhvillimin e këtij fenomeni nuk kanë arritur të eliminohen tërësisht, pavarë-

sisht zhvillimeve që kanë ndodhur me kalimin e kohës.

Hapi i parë për krijimin një shoqërie të shëndetshme është rritja e shkallës së ndërgjegjësimit kolektiv mbi shkaqet si dhe pasojat e korrupsionit në shoqëri. Gjithashtu, është e paevitueshme ndihma e qeverisë në ndikimin e uljes së nivelit të korrupsionit, kjo duke rritur transparencën me qytetarët, ndëshkimin me ligj të iniciatorëve të korrupsionit, arritjen e një stabiliteti ekonomik. Pra, hallka kryesore për reduktimin e këtij fenomeni është zbatueshmëria me përpikëri e legjislacionit nga ana e gjithsecilit. Kjo do të ndikojë, gjithashtu, në rritjen e shkallës së integriteti ekonomik, politik e social të vendit tonë, në rajon e më gjerë. Prandaj indiferenca nuk është përgjigje!

Detyra jonë si individë është të ndihmojmë në prosperitetin e vendit tonë, arritjen e një stadi më të lartë të mirëqenies dhe sigurimin e një të ardhmeje me të shëndetshme për brezat pasardhës.

Korrupsioni është një sfidë e madhe për demokracinë dhe sundimin e ligjit. Ai rezulton në vendime dhe shpërndarje të burimeve që nuk pasqyrojnë interesat e publikut dhe përqendrojnë fuqinë politike në duart e pak personave. Kjo nga ana tjetër bën që udhëheqësit dhe institucionet politike të humbasin legjitimitetin dhe besimin publik, gjë që zvogëlon aftësinë e tyre për të qeverisur.

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit European 2020 për Shqipërinë (që mbulon periudhën kohore maj 2019 - tetor 2020), vendi ka përparuar mjaft mirë në luftën kundër korrupsionit. Autoritetet shqiptare përforcuan kapacitetet operacionale, koordinuese dhe monitoruese në luftën kundër korrupsionit, duke plotësuar kështu kushtin për Konferencën e parë Ndërqeveritare. Shqipëria ka vazhduar përpjekjet për krijimin e historikut të plotë në hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit. Megjithatë vetëvendi i anëtarëve të gjyqësorit është proces administrativ, është e rëndësishme të vlerësohen rezultatet konkrete të Shqipërisë për të luftuar korrupsionin. Ndërkohë që numri i hetimeve në vazhdim mbetet i lartë, deri më sot, dënimet përfundimtare në çështjet që përfshijnë zyrtarët e lartë mbeten ende të kufizuara. Organet e sapokrijura të specializuara kundër korrupsionit (SPAK- Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) priten të forcojnë ndjeshëm kapacitetin e përgjithshëm për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit.





RAJONI ADRIATIK - JON

Rajoni Adriatik-Jon është një zonë funksionale e përcaktuar kryesisht nga pellgu i detit Adriatik dhe Jon. Duke mbuluar gjithashtu një sipërfaqe të rëndësishme tokësore, ai i trajton zonat detare, bregdetare dhe tokësore si sisteme të ndërlidhura. Me lëvizjet e intensifikuara të mallrave, shërbimeve dhe njerëzve për shkak të anëtarësimit të Kroacisë në BE dhe me perspektivën e anëtarësimit në BE për vendet e tjera në rajon, brendësia e porteve luajnë një rol të rëndësishëm. Vëmendja ndaj lidhjeve tokë-det gjithashtu thekson ndikimet e aktiviteteve të paqëndrueshme me bazë tokësore në zonat bregdetare dhe ekosistemet detare.

Strategjia e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) është një strategji makro-rajonale e miratuar nga Komisioni Europian dhe nga Këshilli Europian në vitin 2014. Strategjia është zhvilluar bashkërisht nga Komisioni dhe vendet e palët e interesuara të Rajonit Adriatiko-Jonian, të cilat ranë dakord të punojnë së bashku në fushat me interes të përbashkët për të mirën e secilit vend dhe të gjithë rajonit.

Strategjia e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit është një nga katër strategjitë makro-rajonale të BE-së, përveç Strategjisë së BE-së për Rajonin e Detit Baltik (2009), Strategjisë së BE-së për Rajonin e Danubit (2011) dhe Strategjisë së BE-së Rajonin e Alpeve (2016).

EUSAIR mbulon dhjetë vende: katër shtete anëtare të BE-së (Kroacia, Greqia, Italia, Sllovenia) dhe gjashtë vende jo anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, San Marino, Serbia).

Objekti i përgjithshëm i EUSAIR është të promovojë prosperitetin dhe rritjen ekonomike dhe sociale në rajon duke përmirësuar atraktivitetin, konkurrencën dhe lidhjen e tij. Vendi i më shumë se 70 milionë njerëzve, Rajoni luan një rol kyç në forcimin e vazhdimësisë gjeografike në Europë.

Strategjia bazohet në Iniciativën Adriatiko-Joniane dhe formon bashkëpunim të ngushtë me të.

Me katër vende anëtare të BE-së dhe katër vende jo të BE-së, strategjia do të kontribuojë në integrimin e mëtejshëm të Ballkanit Perëndimor.

Prioritetet e EUSAIR:

Prioritetet/flamurët e EUSAIR u propozuan si zgjidhje për sfidat kryesore me rëndësi makro-rajonale në përputhje me nevojat kombëtare, si dhe me objektivat e politikës së BE-së për një Europë më të gjelbër, me karbon të ulët dhe më të lidhur. Vendet do të përmbushin vepërime konkrete në nivel kombëtar për të ndjekur qëllimet/zgjidhjet e përbashkëta për rajonin.

Vendet pjesëmarrëse të EUSAIR ranë dakord për fusha me interes të ndërsjellë me rëndësi të lartë për vendet Adriatiko-Joniane, duke qenë sfida apo mundësi të përbashkëta. Vendet synojnë të krijojnë sinergji dhe të nxisin koordinimin midis të gjitha territoreve në Rajonin Adriatiko-Jonian në katër fushat/shtyllat tematike:

Strategjia e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit është një nga katër strategjitë makro-rajonale të BE-së, përveç Strategjisë së BE-së për Rajonin e Detit Baltik (2009), Strategjisë së BE-së për Rajonin e Danubit (2011) dhe Strategjisë së BE-së Rajonin e Alpeve (2016).

FORUMI VJETOR EUSAIR

Forumi i 7-të i Strategjisë së BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit, organizuar nga Republika e Shqipërisë dhe Komisioni Europian

Shtylla 1:
Rritja blu

Koordinatorë: Greqia dhe Mali i Zi.

Objektivat specifike për këtë shtyllë janë:

-Të promovojë kërkimin, inovacionin dhe mundësitë e biznesit në sektorët e ekonomisë blu, duke lehtësuar qarkullimin e trurit ndërmjet komuniteteve të kërkimit dhe biznesit dhe duke rritur kapacitetin e tyre të rrjetëzimit dhe grupimit.

-Të përshtaten me prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm të prodhimeve të detit, duke zhvilluar standarde dhe qasje të përbashkëta për forcimin e këtyre dy sektorëve dhe duke ofruar kushte të barabarta loje në makro-rajon.

-Përmirësimi i qeverisjes së pellgjeve detare, duke rritur kapacitetet administrative dhe institucionale në fushën e qeverisjes dhe shërbimeve detare.

Për të arritur objektivat e lartpërmendura, Shtylla 1 do të fokusohet në tre tema: Tema 1 - Teknologjitë blu; Tema 2 - Peshkimi dhe akuakultura; Tema 3 - Qeverisja dhe shërbimet detare dhe detare

Shtylla 2:
Lidhja e rajonit

Koordinatorë: Italia, Serbia dhe Maqedonia e Veriut

Objektivat specifike për këtë shtyllë janë:

-Të forcojë sigurinë dhe sigurinë

detare dhe të zhvillojë një sistem portual intermodal rajonal konkurrues.

-Të zhvillojë rrjete të besueshme transporti dhe lidhje intermodale me brendësinë e vendit, si për mallrat ashtu edhe për pasagjerët.

-Të arrihet një treg i brendshëm i energjisë i ndërlidhur mirë dhe mirë-funksionues, duke mbështetur tre objektivat e politikës energjetike të BE-së: konkurrencën, sigurinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë.

Për të arritur objektivat e lartpërmendura, shtylla 2 do të fokusohet në tre tema: Tema 1 - Transporti detar; Tema 2 - Lidhjet intermodale me brendësinë; Tema 3 - Rrjetet energjetike

Shtylla 3:
Cilësia e mjedisit

Koordinatorë: Sllovenia dhe Bosnje-Hercegovina

Objektivat specifike për këtë shtyllë janë:

-Të sigurojë një status të mirë mjedisor dhe ekologjik të mjedisit detar dhe bregdetar deri në vitin 2020 në përputhje me vendimet përkatëse të BE-së dhe qasjen e ekosistemit të Konventës së Barcelonës.

-Të kontribuojë në qëllimin e Strategjisë së Biodiversitetit të BE-së për të ndaluar humbjen e biodiversitetit dhe degradimin e shërbimeve të ekosistemit në BE deri në vitin 2020, dhe për t'i rivendosur ato që janë humbur, duke adresuar kërcënimet ndaj biodiversitetit detar dhe tokësor.

-Për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve duke reduktuar rrjedhat e

mbetjeve në det dhe për të reduktuar rrjedhat e lëndëve ushqyese dhe ndotësve të tjerë në lumenj dhe det.

Dy tema janë identifikuar si thelbësore në lidhje me cilësinë mjedisore në Rajonin Adriatiko-Jon: Tema 1 - Mjedis detar; Tema 2 - Habitatet tokësore transnacionale dhe biodiversiteti.

Shtylla 4:
Turizmi i qëndrueshëmKoordinatorë: Kracia dhe Shqipëria
Objektivat specifike për këtë shtyllë janë:

-Diversifikimi i produkteve dhe shërbimeve turistike të makro-rajonit së bashku me trajtimin e sezonalitetit të kërkesës së turizmit të brendshëm, bregdetar dhe detar.

-Përmirësimi i cilësisë dhe inovacionit të ofertës turistike dhe rritja e kapaciteteve turistike të qëndrueshme dhe të përgjegjshme të aktorëve turistikë në të gjithë makro-rajonin.

Për të arritur objektivat e lartpërmendura, shtylla 4 do të fokusohet në dy tema: Tema 1 - Oferta e larmishme turistike (produkte dhe shërbime); Tema 2 - Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm i turizmit (novacioni dhe cilësia).

Video-mesazh për Forumin e 7-të vjetor të Strategjisë së Bashkimit Europian për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), Tiranë, Shqipëri

“Sot më shumë se kurrë kemi nevojë për bashkëpunim. Për rimëkëmbjen ekonomike nga pandemia, për një përgjigje ndaj agresionit rus, për mbështetjen ndaj refugjatëve ukrainas dhe për një krizë klimatike që kërkon nga ne të ndryshojmë rrënjësisht ekonominë dhe mënyrën tonë të jetesës.

Në të gjitha këto kontekste, ne duhet të punojmë së bashku dhe bashkëpunimi duhet të jetë baza solide e çdo përgjigjeje serioze.

Pra, mirë se vini në këtë forum vjetor për rajonin e Adriatikut dhe Jonit. Një mirëseardhje e veçantë për San Marinon, anëtarin më të ri të familjes.

Dhe falënderimi im i veçantë për autoritetet shqiptare për punën e tyre në kryesinë e forumit. Dhe ka punë për të bërë. Ky është një makro-rajon me potencial të jashtëzakonshëm rritjeje: disa nga rajonet e tij janë tashmë motorët kryesorë të ekonomisë europiane, por unë besoj fuqimisht se ne kemi këtu shumë motorë të tjerë kyç të ardhshëm të ekonomisë europiane. Por ka hapa të ndryshëm praktikë që duhet të ndërmerren së pari. Për disa vende, përgatitja për zgjerim. Dhe për të gjitha vendet, përmirësimi i lidhjeve, mbrojtja e biodiversitetit dhe shfrytëzimi më i mirë i aseteve të pafundme rajonale, nga të rinjtë të trashëgimia kulturore, si dhe burimi i jashtëzakonshëm i një prej deteve më të bukura në botë.

I mirëpres prioritetet e presidencës shqiptare. Për këtë të ardhme të suksesshme, ne duhet të mbajmë të rinjtë. Ne duhet të trajtojmë ikjen e trurit dhe ta bëjmë rajonin tërheqës për të rinjtë e zgjuar dhe dinamikë.

Pra, mirëpres iniciativën për t'i përfshirë më thellë, përmes Këshillit Rinor. Dhe kjo bie në një moment të përshtatshëm, ku viti 2022 është Viti Europian i Rinisë dhe Tirana Kryeqyteti Rinor. E di që do të shfrytëzoni sa më shumë nga këto mundësi.

Unë mirëpres gjithashtu projektin tuaj për të sjellë Marrëveshjen e Gjelbër në rajon, nga organizimi i konferencave deri te rritja e prokurimit publik të gjelbër. Kjo është inkurajuese, por gjithashtu ju bëj thirrje që të mobilizoni fondet e investimeve, çka nënkuptojmë kur flasim për procesin e “ngulitjes”. Unë gjithashtu e mirëpres punën tuaj për të lehtësuar zgjerimin. Rajoni përfshin disa nga rajonet më të zhvilluara dhe disa nga rajonet më pak të zhvilluara të Europës. 5 vendet kandidatë, dhe kandidatë potenciale, kanë mundësinë të mësojnë nga disa prej më të mirëve. Për të marrë gjithçka, nga kapaciteti administrativ deri te të mësuarit rreth proceseve të BE-së, duke përfshirë proceset e politikës së kohezionit.

Si përfundim, teksa përballemi me sfidat e sotme, nga ekonomia e mjedisit, nga ikja e trurit të refugjatëve, nuk ka asnjë problem, për të cilin zgjidhja është më pak bashkëpunimi. Të gjitha sfidat kërkojnë që ne të punojmë së bashku. Mbi bazën e vlerave tonë të përbashkëta europiane, nga demokracia te shteti i së drejtës. Mbi bazën e një angazhimi të përbashkët për solidaritetin dhe për t'u afruar më shumë. Dhe me besimin se bashkëpunimi është në rrugën e vetme për një të ardhme më të mirë.

Le të jetë bashkëpunimi drita jonë udhërrëfyese si në rrugëtimin përpara ashtu edhe në forumin sot. Ju uroj diskutime të frytshme!”

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Bolena është fshati i Kurveleshit të Poshtëm dhe gjendet e vendosur në rrëzë të malit të Çipinit. Fshati Bolenë është si një ballkon për të gjitha fshatrat e krahinës së Labërisë. Fshati ka bërë histori, ka rrezatuar vlera e ka nxjerrë burra atdhetarë, luftëtarë e mendimtarë, që përherë e në çdo kohë kanë mbajtur penën me bojë, pushkën të vajosur e gjykimin e mprehtë e të arsyeshëm. Bolena është e ushqyer me besimin dhe gatishmërinë për t'i shërbyer devotshmërisht Atdheut. Familje të mëdha trimash, injektonin këtë realitet të pakontestueshëm, jepnin mesazhe që: atje ku kishte nevojë Shqipëria në këmbë dhe atje gjendesh djalëria nga Bolena. Bolena krenohet me emrin e Toto Hosit dhe Rubie Hosit, burrë e grua që luftuan me trimëri në Luftën e Vlorës të vitit 1920. Në LANÇ mbi 127 bolenasit u rreshtuan në formacionet partizane, dhe 51 bolenas burra dhe gra, lanë gjakun e tyre për Atdhe dhe ranë dëshmorë në altarin e lirisë.

Në këtë fshat gjendet dhe fisi i nderuar Aliko. Ky fis gjenetikisht në histori është shquar për familje patriotike dhe atdhedashëse. Në Bolenë Alikojt janë shquar për trimëri dhe bujari, për luftëtarë dhe punëtorë të ndershëm. Ky fis u përfshi gjerësisht në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Përmendim Asim Alikon, Heroin e Popullit, kryetarin e Këshillit Nacionalçlirimtar të fshatit në vitet e zjarra të luftës. Në këtë familje atdhetare lindi në Bolenë, më 12 shkurt 1937 Avdyl Demir Aliko, i cili në jetë do të shquhej dukshëm për kontributin që dha në jetën e tij, si inxhinier ushtarak dhe si veprimtar e bashkëpunëtor i palodhur i shoqatave atdhetare. Në vendlindje mori edukimin e parë arsimor, mori edukatën dhe përkujdesjen familjare e patriotike të vendlindjes, dhe u dallua mbi të gjithë për rezultate të larta, duke e përfunduar shkollën 7-vjeçare në vitin 1954. Avdyli me njohuritë e fituara nisi rrugëtimin drejt dijes, duke ndjekur studimet në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” të cilën e përfundoi me rezultatin shkëlqyeshëm.

Koha kërkonte që formacionet e dikurshme partizane, të shndërroheshin në formacione të një ushtrie popullore në shërbim të vatanit dhe kombit. Djemtë e Bolenës e kishin marrë nga historia këtë meritë. Një nga këta, ishte Avdyli, i cili në muajin shtator të vitit 1954, nis studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”. Rrezaton vlerë, përkushtim për dije, disiplinë njerëzore e shoqërore dhe prandaj, fill pas një viti, më 1955, Avdyli shkon me bursë për studime të mëtejshme ushtarake në ish-Bashkimin Sovjetik, në fushën e Piroteknikës, në degën e municioneve dhe lëndëve plasëse.

Ishte krenari të shërbeje në ushtri

Ushtria shqiptare nuk kishte kuadro të mjaftueshëm, për ndërsa koha kërkonte modernizimin dhe njohjen e artit të kohës, të mjeteve luftarake dhe logjistike, me armatime e municione të nevojshme. Nga gjiri i popullit, nga familjet e varfra kontribuuese për lirinë e fituar, me meritokracinë individuale, u bë hap pas hapi, kualifikimi dhe përgatitja e kuadrove oficerë në fusha e specialitete të ndryshme. Një krenari e Ushtrisë Popullore shqiptare ishte dhe Avdyli, i cili në qershor të vitit 1959, përfundon studimet në ish-Bashkimin Sovjetik, me rezultate të shkëlqyera. Një krenari e ligjshme

KRYEINXHINIERI USHTARAK AVDYLI ALIKO LA GJURMË NË JETË

Në gjurmë të traditave



atëherë, djalë i ri dhe i papërmbajtur, i cili më 1 shtator 1959, kthehet në Shqipëri, titullohet “oficer”, realizon ëndrrën, amanetin e prindërve dhe djersën tij, duke marrë emërimin e parë si oficer, në grupin detar të Bazës Ushtarake në Durrës. Pas një viti pune në qytetin bregdetar, Avdyli transferohet në depot e armatës në Qaf Shtamë, Burrel, në një detyrë me shumë përgjegjësi.

Karakterit dhe tipi i Avdyilit, asnjëherë nuk ishte në qetësi, por përherë në lëvizje, asnjëherë i lodhur dhe kurrë i kënaqur me atë ç’ ka kishte bërë. Karakteri dhe djersa fisnikërore, vlerësoshin. Pas një viti shërbim në Burrel, më 16 nëntor 1961, Avdyli thirret për t’u dërguar për specializim në Republikën Popullore të Kinës. Nder dhe krenari për familjen, për veten e vet, por dhe për degën e armatim-municionit të Forcave të Armatosura shqiptare.

Rezultatet dhe sjelljet e shkëlqyera që e pasuan gjatë tërë studimeve të larta në Kinë, më 1 shkurt 1963, pasi kthehet nga Kina, emërohet në Uzinën e Mjekësit. Uzina ishte në ndërtim e sipër dhe Avdyli emërohet në detyrën e lartë të kryeinxhinierit të uzinës. Ishte ky një vlerësim dinjitoz, për rëndësinë e madhe që kishte uzina në formacionet e të gjithë uzinave ushtarake të kohës, me një teknologji të avancuar dhe moderne.

Një jetë të tërë punoi në këtë uzinë nga viti 1963 e deri në vitin 1992. Avdyli rrezatoi në uzinë, që nga themelet e deri në prodhim, përkushtimin e veçantë profesional, inxhinieroteknik, duke marrë respektin dhe konsideratat e larta të efektivitetit, personelit dhe të të gjithë eprorëve, vartësve dhe bashkëpunëtorëve të tij. Rrallë janë ata profesionistë që e mbyllin kaq shkëlqyeshëm jetën e tyre të punës. Nga kjo uzinë Avdyli, e filloi dhe e përfundoi me nder e lavdi detyrën ushtarake deri kur doli në pension. I vlerësuar dhe nderuar në shoqata.

Në vitin 1998, vendoset me banim në Kombinat në Tiranë. Avdyli nuk mund të rrijë i qetë, të “çlodhë kockat”, sepse çlodhje ai quan virtytin e lëvizshmërisë në punë, përherë i gatshëm për misione shoqërore, intelektuale e vlerëpërhapëse.

Me një grup nismëtarësh, labësh intelektualë të përkushtuar, organizohet në shoqatën “Labëria” në kombinat, së bashku me labët e përkushtuar Hysni Tartari dhe Bajram Rexhepi. Avdyli me fillimin e shekullit XXI u gjend në kombinat, por vendlindja e tij e dashur e thërret dhe i ngarkon detyrën e kryetarit të shoqatës “Bolena”. Në të gjithë këto vite Avdyl Aliko u shqua në Shoqatën “Labëria” në kombinat, për punën e palodhur, për mendimet e dhëna, për një organizim efektiv dhe luajal, i pa

mërzitur dhe që kurrë nuk kërkon lavdi dhe privilegje. Për punën plot përkushtim Avdyli u vlerësua me titullin “Kryetar nderi” dhe me “Mirënjohjen e Labërisë”.

Këtë meritë dhe vlerësimin Avdyl Aliko e ka marrë me zemër, pasi nuk u lodh kurrë në organizimet dhe veprimtarinë e shoqatës së “Labërisë” në kombinat, dhe kur flasim për shoqatën e Labërisë në kombinat, nuk mund të mos parafytyrojmë dhe të ndjejmë atje, punën dhe mendjen e Avdyilit, pa anashkaluar bashkëpunimin e ngushtë që vetë Avdyli ka bërë me Xhemil Çelin, Iliaz Norën, Zhulieta Zamanin, Muharrem Merkohasanin, Bashkim Qelin, e të tjerë.

Vlerë e pamohueshme e Labërisë

E ndërsa vitet ecin, të duket ndonjëherë sikur njerëzit harrohen. Por në fakt, punët dhe veprat që bëjnë më të shquarit, veprimtarët, mbeten në altarin e historisë së Labërisë. Por, për Avdylin njeri, Avdylin pasionant e veprimtar, Avdylin e përkushtuar në shoqatën “Labëria” respekti ishte i pranishëm jo vetëm nga labët, por dhe nga njerëzit e shumte që e njihnin në jetë inxhinierin ushtarak. Ai e nisi veprimtarinë shoqërore si lab, falë cilësisë që ofroi dhe përkushtimit maksimal, duke qenë një nga nismëtarët në kombinat për Labërinë.

Në këto vite Avdyli ka qenë në krye të veprimtarisë së shoqatës, pa bujë, thjesht, duke afirmuar vlerat më të spikatura dhe dinjitoze të një labi të vërtetë. Kur e takojë Avdylin, gëzoje se takojë burrin e Labërisë, njeriun fisnik, model dhe me vlera që na duhej të gjithëve. Këtë e pashë dhe e gjeta tek Avdyli, në vite pune e sakrifica të bëra, pa interes, duke u lodhur, e duke u gjendur aty ku e kërkonte Labëria. Ai dha shembullin e burrit të mençur dhe njeriut bujar e të thjeshtë, gjithmonë me mirësi dhe dashuri për të gjithë. Kishte kaluar shumë halle në jetë, kishte humbur bashkëshorten dhe një djalë, si dhe i sëmuret djali tjetër e bëhet i paafët. Në kohën e demokracisë dhe djali tjetër emigron në Kanada. Por Avdyl Aliko, si ushtarak e si lab nuk u mposht, gjeti forca dhe i përballoi me guxim vështirësitë e jetës dhe iu përkushtua jetës shoqërore. Ai me kurajë e vullnet, gjeti rrugën dhe u ngrit mbi hallet dhe vështirësitë, duke dhënë shembull me një sakrificë të paparë. Ndaj ai na ka dhënë një vlerë dhe model në rrugën tonë.

Figura e tij ishte një me vlerën e paçmueshme e një atdhetari. Avdyli përfaqësonte tipikun dhe modelin e veprimtarit të përkushtuar, ndaj dhe shoqëria Labëria e ka çmuar dhe vlerësuar në vite se ka gjetur mbështetje. Kjo mbështetje e bëri burim krenarie dhe inkurajimi. Në çdo hap të jetës së tij ne kemi vërejtur frymën e kolegalitetit, të shpirtit bujar dhe krijues të labit, kulturën e gjerë, mendimin filozofik popullor, ecjen përpara drejt një qëllimi, atë të ruajtjes dhe të përcjelljes së traditave të Labërisë.

Avdyl Aliko, përfaqësonte labin e mençur që u përball me jetën si i vinte, u përpoq të merrte të mirat që iu afruan, mësoi prej tyre dhe synoi t’i sundonte ato. Avdyli në jetën e tij 85-vjeçare la në shoqëri mençurinë, bujarinë, e njeriut fjalëpakë e punëmbaaruar, si dhe dha mesazhe dashurie dhe mirëkuptimi për të gjithë.

Vera Demo-Lesko ka lindur më 17 nëntor të vitit 1947, në Vlorë. Në vendlindje ka kryer me rezultate të mira shkollën shtatëvjeçare dhe shkollën e mesme (gjimnazin) “Halim Xhelo” të këtij qyteti. Në vitet 1967-1969, ka përfunduar me rezultate shumë të mira studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, dega Radio-mjeshtre. Pas titullimit “Oficere aktive” me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nis punë në profesionin e saj në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.

NGA KOLANA E LIBRIT “OFICERET SHQIPTARE NË RRJEDHËN E HISTORISË”

Vera Lesko, oficerja shqiptare që mori dekoratën “Heroinë e Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, nga Hilari Klinton



VERA LESKO

Kontributi i saj në Shqipëri e jashtë saj, është vlerësuar sistematikisht, veçanërisht nga institucione prestigjioze të njohura, qeveri shtetesh e forumeve të ndryshme. Kështu, në vitin 2003, i jepet “Çmimi Ndërkombëtar Anti Skllavëri” nga “Organizata Ndërkombëtare Anti Skllavëri” me qendër në Londër. Në vitin 2008 merr “Çmimin e Mirënjohjes” me motivacionin “Për kontributin e dhënë në komunitet”, nga Organizata Kombëtare “Gratë Mbështesin Gratë”. Në vitin 2009 merr çmimin “Mondial Heroine e Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, dhënë në Washington nga Hilari Klinton.

Shqipëri për gratë dhe vajzat e përfshira në trafikimin e qënieve njerëzore. Nga 1999 e në vazhdim, është pjesëmarrëse

dhe folëse në konferenca të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, e ftuar dhe diskutante në Parlamentin e An-

glisë, në Parlamentin Europian, në konferenca në shtete si Angli-Londër, Itali, Austri -Vjenë, Bosnje, Spanjë,

Greqi, Amerikë, Hungari, Ukrainë, Belgjikë etj. Nga viti 1999, deri në vitin 2009, Vera është drejtoreshë e qendrës “Vatra” etj.

Kontributi i saj në Shqipëri e jashtë saj, është vlerësuar sistematikisht, veçanërisht nga institucione prestigjioze të njohura, qeveri shtetesh e forumeve të ndryshme. Kështu, në vitin 2003, i jepet “Çmimi Ndërkombëtar Anti Skllavëri” nga “Organizata Ndërkombëtare Anti Skllavëri” me qendër në Londër. Në vitin 2008 merr “Çmimin e Mirënjohjes” me motivacionin “Për kontributin e dhënë në komunitet”, nga Organizata Kombëtare “Gratë Mbështesin Gratë”. Në vitin 2009 merr çmimin “Mondial Heroine e Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, dhënë në Washington nga Hilari Klinton. Po në vitin 2009, merr çmimin ndërkombëtar “Gruaja e Kurajës”, e organizuar nga Zonja e Parë Mishel Obama, dhënë në Ambasadën Amerikane në Tiranë. Në vitin 2010, merr çmimin nga qeveria shqiptare “Ambasadore Nderi”. Në vitin 2009, i jepet çmimi “Protagonisti i Vitit”, dhënë nga Bashkia Vlorë etj...

Si intelektualët shqiptarë nga më të vlerësuar ndërkombëtarisht, Vera Lesko-Demo, ka zënë vend vazhdimisht në median prestigjioze ndërkombëtare (atë televizive e në gazeta) dhe atë shqiptare. Njëkohësisht, ajo ka një kontribut të rëndësishëm në fushën e botimeve studimore, shkencore e librave. Ndër ta mund të përmendim: në vitin 2000 boton librat “Përmasë Trafikut të Femrave” dhe “Refleksion Për Gruan”; në vitin 2002 boton librin “Vajzat dhe Trafikimi”; në periudhën 2006-2007, boton librin “Gruaja në vendimmarrje dhe politikë”; në vitin 2007 boton përmbledhjen “Cikël temash për shkollat e mesme mbi trafikimin”; në vitin 2009 librin “Vajzat dhe trafikimi”; broshura të shumta që lidhen me trafikimin e grave, problemeve sociale e shoqërore të tyre, fletëpalosje etj.

Vera Lesko, oficerja e njohur e ndërlidhjes, oficerja korrekte e tejet e aftë në anën profesionale, e vlerësuar kudo punoi e drejtoi, pas nxjerrjes në rezervë, iu përkushtua tërësisht problemeve sociale të tranzicionit të gjatë pas ndryshimeve të sistemeve në vitin 1990, kryesisht në mbrojtje të vajzave të trafikuar, frenimin e këtij problemi të mprehtë e të rëndë social e shoqëror sidomos në vitet e para, duke qenë një aktiviste me vlera kombëtare e ndërkombëtare, e vlerësuar maksimalisht nga organizmat e qeveritë më të fuqishme botërore. Mes dhjetëra çmimeve e titujve që ka marrë si aktiviste shoqërore, është ai i vitit 2009, “Mondial Heroine, e Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, dhënë në Washington nga Hilari Klinton; ai i vitit 2003, “Çmimi Ndërkombëtar Anti Skllavëri”, dhënë nga “Organizata Ndërkombëtare Anti Skllavëri” me qendër në Londër e shumë të tjerë. Po ashtu, ajo është autore e shumë librave prestigjiozë për problemet sociale të femrës shqiptare e shumë më gjerë.

Vera Demo-Lesko ka lindur më 17 nëntor të vitit 1947, në Vlorë. Në vendlindje ka kryer me rezultate të mira shkollën shtatëvjeçare dhe shkollën e mesme (gjimnazin) “Halim Xhelo” të këtij qyteti. Në vitet 1967-1969, ka përfunduar me rezultate shumë të mira studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, dega Radio-mjeshtre. Pas titullimit “Oficere aktive” me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nis punë në profesionin e saj në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitet 1969-1976 ka punuar në detyra të ndryshme, deri në shefe e ndërlidhjes së Brigadës së Këmbësorisë. Në periudhën 1983-1992, ka kryer detyrën e shefes së kuadrit (personelit) në Brigadën e Këmbësorisë dhe më pas të njëjtën detyrë në Divizionin e Fierit. Në vitin 1992, në kuadër të reformave të njëpasnjëshme në strukturat ushtarake pas ndryshimeve të sistemeve politike në vend, e nxjerrin në rezervë me urdhër të ministrit të Mbrojtjes. Në atë kohë nuk i kishte mbushur 45 vjeç. Në vitin 1995, është aktivizuar me shoqërinë civile në Tiranë. Në vitin 1997, zgjidhet Presidente e grupimit “Vatra e Gruas Vlonjate”. Në vitin 1999, ngre të parën qendër në



Prezantimi i “Quesst”: Emër i ri, mision i njëjtë



Shpejtësia nuk ka tingëlluar kurrë kaq e qetë

Duke evokuar natyrën eksperimentale të testimit të fluturimit dhe frymën e eksplorimit aeronautik, “Quesst” është ajo që NASA po e quan misionin e saj për të mundësuar udhëtimin ajror supersonik mbi tokë. Ky emër i ri, i kompletuar me një “s” shtesë për të përfaqësuar “supersonik”, e merr frymëzimin e tij nga trashëgimia e gjatë e kërkimeve mbi fluturimet supersonike të NASA-s. Trashëgimia e NASA-s për studimin e fluturimit supersonik arrin më shumë se 70 vjet më parë. Kjo njohuri e akumuluar, veçanërisht kur lidhet me të kuptuarit e zhurmave të zërit dhe si t’i bëjmë ato më të qeta, është në qendër të misionit. U deshën vite punë të palodhur dhe më të fundit në testimin e tunelit të erës, mjetet e avancuara të simulimit kompjuterik dhe testimin aktual të fluturimit për të arritur në këtë pikë ku është koha për të provuar teorinë në ajër me një aeroplan X supersonik në shkallë të gjerë.

Pjesa qendrore e misionit është avioni kërkimor elegant i njohur si “X-59”, të cilin “Lockheed Martin Skunk Works” po e ndërton aktualisht në Palmdale, Kaliforni.

“Quesst” zëvendëson emrin origjinal të misionit “Demonstrimi i Fluturimit me Zhurmë të Ulët”. “Me Quesst, ne kemi gjetur një emër që përcjell në mënyrë efektive qëllimin, rëndësinë dhe, më e rëndësishmja, entuziazmin e asaj që është ky mision”, -tha Peter Coen, menaxheri i integritetit të misionit të NASA-s për “Quesst”.

Nëpërmjet “Quesst”, NASA planifikon të demonstrojë se “X-59” mund të fluturojë më shpejt se zëri pa gjeneruar zhurmat e forta zanore që prodhojnë zakonisht avionët supersonikë. Ky tingull bubullues është arsyeja që SHBA-të dhe qeveritë e tjera ndaluan shumicën e fluturimeve supersonike mbi tokë.

Aeroplani X-supersonik i NASA-s i ndërtuar në dekada, së shpejti do të ngrihet në qiell. Një pilot i vetëm duhet të fluturojë avionin 30.35 m të gjatë dhe 8.99 të gjerë, të mundësuar nga një motor i vetëm reaktiv. Shpejtësia e tij e kërkimit të projektimit do të jetë 925 metër në orë, duke fluturuar në 16 764 m. NASA do të përdorë “X-59” eksperimentale për të ofruar të dhëna që mund të ndryshojnë rregullat që ndalojnë fluturimin supersonik mbi tokë duke vërtetuar se një bum zanor mund të reduktohet në një goditje zanore shumë pak të dëgjueshme në tokë.

Duke punuar me komunitete të zgjedhura, NASA do të fluturojë me “X-59” për të mësuar se si njerëzit reagojnë (nëse dëgjojnë ndonjë zhurmë) ndaj zvogëlimit të “goditjes” së zërit që prodhon. Agjencia do të ndajë të dhënat e sondazhit me rregullatorët, me shpresën se ata do të konsiderojnë shkrimin e rregullave të reja që heqin ndalimin.

Pamja e re e “Quesst”

Me prezantimin e “Quesst” vjen një identitet i ri i misionit, një shenjë nënshkrimi blu dhe jeshile që përfaqëson elementet e “Quesst”.

Grafiku i ri i misionit shfaq valë tronditëse të stilizuara supersonike që rrethojnë avionin kërkimor, teksa fluturon mbi një komunitet shtëpish. Imazhet nxjerrin në pah kërkimin novator që do të kryhet në disa qytete të SHBA-së gjatë këtij misioni.

Frymëzimi për dizajnin vjen nga imazhet e kapura gjatë serisë së fluturimit të NASA-s 2019, të orientuar në sfond, Schlieren (AirBOS), i cili regjistroi imazhe të valëve goditëse të kryqëzuara nga avionët supersonikë.

Këtu është një përmbledhje e dizajnit



dhe paleta e tij e ngjyrave:

- Valët goditëse supersonike, të paraqitura në të gjelbër, nuk bashkohen. Kjo është ajo që i mundëson “X-59” të prodhojë një goditje zanore më të qetë.

- Forma e avionit përfaqëson “X-59”. Ndërsa më parë njihet si “Teknologjia e Qetë SuperSonike X-59”, avioni tani thjesht do të quhet “X-59”.

- Të tre shtëpitë përfaqësojnë komunitetet që do të ofrojnë të dhënat që mund të lejojnë fluturimin e ardhshëm komercial supersonik mbi tokë.

- Gjysmëhëna përfaqëson tokën, duke nxjerrë në pah aspektin vendimtar dhe unik të misionit, fluturimin komercial supersonik mbi tokë.

- Në përgjithësi, ngjyra blu dhe jeshile simbolizojnë Tokën, dhe ku vlera e kërkimit të NASA-s për aeronautikën përjetohet nga njerëzimi çdo ditë.

Plani i kërkimit

Për të arritur qëllimet e saj të misionit, NASA ka paraqitur “Quesst” në tre faza. Faza e parë dhe aktuale fokusohet në montimin e “X-59”, e ndjekur nga fluturimet fillestare të planifikuara për më vonë këtë vit për të provuar sigurinë dhe performancën e avionit.

Faza e dytë, që pritet të zhvillohet gjatë vitit 2023, do të fokusohet në vlefshmërinë akustike. Gjatë kësaj faze, misioni do të provojë se “X-59” është gati për operate të rregullta në Sistemin Kombëtar të Hapësirës Ajrore. Avioni do të fluturojë mbi Qendrën Kërkimore të Fluturimeve “Armstrong” të NASA-s në Edwards, Kaliforni për të demonstruar se teknologjitë supersonike funksionojnë siç janë projektuar. Fluturimet do të tregojnë gjithashtu se mjetet e përdorura për të parashikuar dhe matur nivelin e zërit të goditjes së zërit janë gati për përdorim në fazën e tretë.

Me gjasë pika më e prituri në mision, faza e tretë do të shfaqë “X-59” që fluturon mbi disa komunitete në të gjithë SHBA-në, duke mbledhur të dhëna nga publiku për të mësuar se çfarë mendojnë njerëzit për tingullin e “X-59”.

Kjo fazë pritet të zhvillohet nga viti 2024 deri në vitin 2026. NASA ende nuk i ka përzgjedhur komunitetet.

Misioni është vendosur të përfundojë

në vitin 2027 duke marrë informacionin e mbledhur gjatë fazës së tretë dhe duke e ndarë atë me rregullatorët amerikanë dhe ndërkombëtarë. Me informacionin e mbledhur gjatë misionit “Quesst”, shpresa është që t’u mundësohet rregullatorëve të marrin në konsideratë rregullat bazuar në atë se sa zhurmë shkakton një avion, jo bazuar në një shpejtësi arbitrare.

“Misioni ‘Quesst’ ka potencialin për të transformuar udhëtimin ajror siç e njohim ne aktualisht”, -tha Coen. Suksesi i këtij misioni do të hapë derën e udhëtimit të shpejtë ajror për të gjithë në mbarë globin.”

“Quesst” - misioni ku shpejtësia nuk duhet kurrë kaq e qetë: Jim Banke, Drejtori e Misionit Kërkimor të Aeronautikës; Kristen Hatfield, Qendra Kërkimore e NASA Langley

Inovatorët aeronautikë të NASA-s po udhëheqin një ekip qeveritar-industri për të mbledhur të dhëna që mund të bëjnë të mundur fluturimin supersonik mbi tokë, duke reduktuar në një masë të konsiderueshme kohën e udhëtimit në Shtetet e Bashkuara ose kudo në botë.

Misioni “Quesst” ka dy synime: 1) projektimin dhe ndërtimin e aeroplanit kërkimor “X-59” të NASA-s me teknologji që redukton zërin e zhurmës në një goditje të butë për njerëzit në tokë; dhe 2) të fluturojë “X-59” mbi komunitete të zgjedhura të SHBA-së për të mbledhur të dhëna mbi reagimet njerëzore ndaj tingullit të krijuar gjatë fluturimit supersonik dhe për t’ia dorëzuar ato të dhëna rregullatorëve amerikanë dhe ndërkombëtarë.

Duke përdorur këto të dhëna, mund të shkruehen miratohen rregulla të reja të bazuara në zë në lidhje me fluturimin supersonik mbi tokë, të cilat do të hapnin dyert për tregjet e reja komerciale të ngarkesave dhe pasagjerëve për të ofruar udhëtim ajror më të shpejtë se sa zëri.

Elementet e misionit “Quesst” të NASA-s organizohen brenda dy prej programeve aeronautike të agjencisë: Programi i Avancuar i Automjeteve Ajrore dhe Programi i Sistemeve të Integruara të Aviacionit, dhe menaxhohen nga një zyrë projekti sistemesh, anëtarët e së cilës përfshijnë të dy programet dhe të katër qendrat në terren të kërkimit aeronautik të NASA-s: Qendra Kërkimore “Langley” në Virxhinia;

Qendra Kërkimore “Glenn” në Cleveland; dhe Qendra Kërkimore “Ames” dhe Qendra Kërkimore e Fluturimeve “Armstrong”, të cilat ndodhen të dyja në Kaliforni.

Shkenca e Tingullit: NASA shqyrton zhurmën e avancuar të lëvizshmërisë së ajrit

Objekti i Akustikës Mobile i NASA-s dhe një grup prej më shumë se 50 mikrofonesh ndihmuan studiuesit e agjencisë të matin profilin akustik të avionit të Joby-t gjatë një testi në shtator 2021. Burimi: Joby Aviation

“Advanced Air Mobility” (AAM) do të ofrojë opsione të reja transporti ajror, por në mënyrë që këta avionë të gjeneratës së ardhshme të ndajnë qiejt tanë, ata duhet të jenë të qetë. NASA po punon drejt këtij qëllimi, duke zhvilluar mjetet e projektimit që prodhuesit mund të përdorin për të reduktuar ndikimet e zhurmës.

Në shtator 2021, ekipet e Fushatës Kombëtare të NASA-s AAM dhe Teknologjisë Revolucionare të Ngritjes Vertikale kaluan dy javë duke mbledhur të dhëna nga testimi zhvillimor me aeroplanin e ngritjes dhe uljes vertikale tërësisht elektrike të “Joby Aviation” (eVTOL). Pas analizimit të këtyre të dhënave, rezultatet fillestare tani janë gati. Ekipi do të prezantojë punimin e plotë në një konferencë teknike këtë verë.

“Ne do t’i përdorim këto të dhëna për të na ndihmuar të kuptojmë karakteristikat e performancës së automjetit, profilet akustike, si dhe informacionin që do të na ndihmojë të zhvillojmë skenarë modelimi”, -tha Shivanjli Sharma, ushtruese detyre për Fushatë Kombëtare AAM. “Jo vetëm një ose dy fluturime në ditë, por në shkallë që ne parashikojmë se këto automjete do të fillojnë të fluturojnë kur të përdoren nga publiku.”

Ekipet e NASA-s do të kryejnë teste me ngjashme gjatë testeve të ardhshme të fluturimit akustik të Fushatës Kombëtare AAM me partnerin e industrisë Wisk.

Mbledhja e të dhënave akustike

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme, studiuesit e NASA-s vendosën objektin e specializuar të akustikës celulare të agjencisë në bazën elektrike të fluturimit të Joby-it pranë Big Sur, Kaliforni.

Pajisja celulare përmban sisteme matëse akustike me valë që studiuesit mund t’i rregullojnë në grupe të ndryshme për të kapur gjurmën akustike - profilin akustik të avionit në faza të ndryshme të fluturimit. Studiuesit mund të ndryshojnë madhësinë dhe formën e grupit në varësi të kërkesave të testit, automjetit që po studiojnë dhe gjeografisë së vendit të testimit.

Ekipi i NASA-s ndërtoi një grup duke përdorur më shumë se 50 mikrofona për të matur profilin akustik të avionit të Joby-it në fazat e fluturimit që përfaqëson një mision të plotë AAM, duke përfshirë fluturimin, ngritjen, lundrimin dhe uljen. Objekti i Akustikës Mobile ruajtiti të dhënat e mbledhura nga grupi i mikrofonit për studiuesit e NASA-s për t’i analizuar gjatë disa muajve.

Matja e niveleve të zhurmës

Testi i shtatorit ishte pjesë e punës së NASA-s për të mbledhur një koleksion fillestar të të dhënave nga disa avionë të zhvilluar nga industria për të kuptuar profilet akustike të kësaj klase të re automjeteve.

Zhurma ka një komponent objektiv dhe subjektiv - si tingëllon kundrejt mënyrës se si e percepton dëgjuesi. Për këtë testim, NASA po fokusohet në komponentin objektiv. Kjo përfshin mbledhjen e matjeve të presionit akustik, të cilat mund të konvertohen në nivele dhe frekuenca decibel. Nivelet e decibelit nga një avion mund të ndryshojnë për shkak të shumë faktorëve si shpejtësia e avionit, pesha, numri i rotorëve, ndryshimi në shpejtësinë e rotorit dhe kushtet atmosferike si moti.

Aviacioni tradicional dhe industria përdorin informacionin e zhurmës për të zhvilluar rrugët e sotme për avionët e transportit që minimizojnë ndikimin e zhurmës. Këto të dhëna do të informojnë metoda të ngjashme për automjetet e AAM.

Rruga e NASA-s përpara

Sipas studimeve të komunitetit, shqetësimi i publikut për integrimin e automjeteve AAM në hapësirën ajrore zakonisht përfshin nëse automjetet do të jenë shumë të zhurmshme. NASA kërkon të mbledhë dhe analizojë të dhëna nga eVTOL-të si “Joby” për të siguruar që mjetet e projektimit të avionëve të agjencisë parashikojnë saktë nivelet e zhurmës për këto lloje automjeteve. Me mjetet që parashikojnë saktë zhurmën, prodhuesit mund t’i dizajnojnë automjetet e tyre për funksionim të qetë në zonat urbane dhe rurale.

Të dhënat do të ndihmojnë gjithashtu në përcaktimin dhe optimizimin e rrugëve AAM dhe shtigjeve të fluturimit me zhurmë të ulët për nevojat e komunitetit dhe do të ndihmojnë Administratën Federale të Aviacionit (FAA) në krijimin e politikave. Gjithçka e mësuar përmes këtyre testeve do të informojë punën e vazhdueshme të FAA me operacionet dhe integrimin e hapësirës ajrore.

“Joby” dhe NASA do të publikojnë detaje të mëtejshme mbi procedurat dhe matjet në dokumentim teknike që do të prezantohen në konferencat e industrisë këtë verë. Një proces i ngjashëm do të ndiqet pas testimit të partnerëve të tjerë të industrisë.

Teresa Whiting, Qendra e Kërkimit të Fluturimit Armstrong të NASA-s

Më 17 maj Shijaku dhe Tirana u rrethuan nga rebelët, kurse një ditë më vonë u rrethua Durrësi. Dyshimi për organizimin e rebelimit ra mbi Esat Pashë Toptanin për shkak të thashethemeve që u përhapën dhe për shkak të kaluarës së tij me intriga, prandaj më 19 maj ai u arrestua. Po atë ditë rebelët morën Shijakun. Kaosi u shtua pas dëbimit të Esad Pashës. Pas marrjes së Tiranës dhe Shijakut në fund të majit, rebelimi u zgjerua edhe më shumë.



Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, 17 maj 1914 - 8 qershor 1915

Princ Vidi, Mbret i Shqipërisë

Kjo "Lëvizje" klasifikohet tek "Kryengritjet" pasi pati mbështetje popullore tek fshatarët e Shqipërisë së Mesme ku edhe shpërtheu.

Kjo kryengritje nisi më 17 maj 1914 kundër regjimit të Princ Vidit. Kryengritja u nda në 2 faza:

Faza 1: Kryengritësit u drejtuan nga ish-ushtarakë të Perandorisë Osmane, të cilët i dinin të gjitha mënyrat për të mposhtur forcat e Princ Vidit.

Kryengritja shpërtheu në maj 1914. Krerët pro-turq të rebelëve bashkë me emisarët osmanë me të cilët bashkëpunonin u përpoqën të nxisnin paragjykime fetare ndaj Princ Vidit dhe t'i jepnin luftës kundër tij dhe shtetit shqiptar karakterin e një lufte për mbrojtjen e Islamit.

Më 17 maj Shijaku dhe Tirana u rrethuan nga rebelët, kurse një ditë më vonë u rrethua Durrësi. Dyshimi për organizimin e rebelimit ra mbi Esat Pashë Toptanin për shkak të thashethemeve që u përhapën dhe për shkak të kaluarës së tij me intriga, prandaj më 19 maj ai u arrestua. Po atë ditë rebelët morën Shijakun. Kaosi u shtua pas dëbimit të Esad Pashës. Pas marrjes së Tiranës dhe Shijakut në fund të majit, rebelimi u zgjerua edhe më shumë. Në fillim të qershorit morën Krujën dhe Kavajën. Më 15 qershor sulmuan Durrësin, i cili u mbrojt me sukses nga forcat qeveritare të kryesuar nga Gjon Markagjoni, malësorët e Isa Boletinit dhe vullnetarët durrsakë të kryesuar nga Luigj Gurakuqi. Më 17 qershor rebelët sulmuan prapë Durrësin por prapë dështuan ta merrnin. Atë ditë ra Lushnja. Më 21 qershor ra Elbasani. Më pas ranë Fieri dhe Berati.

Duke përfutur nga gjendja e vështirë në të cilën ndodhej vendi për shkak të rebelimit në Shqipërinë e Mesme, forcat vorio-epirote sulmuan dhe pushtuan Kolonjën, Korçën dhe Tepelenën.

Në fund të gushtit rebelët u përgatitën të sulmonin Vlorën, por banorët duke dashur të shmangnin luftën e dorëzuan qytetin vetë, me kusht që flamuri shqiptar të mos prekej. Më 1 shtator rebelët hynë në qytet. Më 5 shtator, dy ditë pas largimit të Princit Vidi nga Shqipëria, rebelët hynë në Durrës dhe ngritën flamurin osman. Drejtuesit e rebelëve dërguan një delegacion në Stamboll për t'i paraqitur qeverisë osmane kërkesën për bashkimin e Shqipërisë me Turqinë dhe për të marrë udhëzime.

Faza 2: Më 2 tetor u kthye në Shqipëri Esat Pashë Toptani. Më parë, kishte firmosur një marrëveshje me kryeministrin serb Nikolla Pashiq me të cilën i premtoje Serbisë aneksimin e Shqipërisë Veriore dhe Lindore, si shpërblim Serbia e ndihmoi me mercenarë dhe me të holla. Në Durrës Esat Pasha shpalli veten kryetar të Qeverisë së Shqipërisë së Mesme. Me anë të grupimeve pro-osmane të kryengritjes e zgjeroi pushtetin në Shqipërinë e Mesme. Ai u premtoi kryengritësve se do t'i shpronësonte bejlerët. Pas hyrjes së Perandorisë Osmane në luftë në anën e fuqive të Boshtit, marrëdhëniet e Esat Pashës me rebelët u përkeqësuan. Esati i cili ishte i lidhur me fuqitë e Antantës ndërmori veprime kundër rebelëve pro-turq kurse këta filluan ta luftonin



Esat Pashën si tradhtar të otomanizmit dhe pronar të madh tokash.

Në nëntor 1914 rebelët dogjën shtëpinë e Esat Pashës në Laprakë dhe hynë në Tiranë ku Haxhi Qamili dogji shtëpitë e bejlerëve dhe agallarëve patriotë. Esat Pasha i cili kishte mbetur i rrethuar në Durrës, mobilizoi me ndihmën e fuqive të huaja rreth 6000 mercenarë për të sulmuar Tiranën, por me të marrë vesh këtë, Haxhi Qamili mobilizoi rreth 2000 fshatarë luftëtarë dhe sulmoi ushtrinë e Esatit në fshatin Zezë afër Krujës duke e shpartalluar. Esati u kthye prapë në Durrës

Në fillim të vitit 1915, Stambolli, i cili tashmë kishte pranuar që Shqipëria të mbetej nën ndikimin e aleatit të saj austro-hungarez, u dërgoi rebelëve udhëzime që të orientonin politikën e tyre

drejt Austro-Hungarisë dhe jo drejt bashkimit me Turqinë. Kjo kthesë shkaktoi përçarje në mesin e udhëheqësve të rebelimit. Njëri krah për shkak të orientimit të ri hoqi dorë nga parullat për bashkim me Turqinë, kurse krahu i pro-turqve fanatikë ku bënë pjesë Haxhi Qamili dhe Man Picari, vazhduan t'i konsideronin parullat pro-turke si programin kryesor të kryengritjes.

Më 9 maj 1915 në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të rebelëve, u zgjodh kryetar Musa Qazimi, kurse më 13 maj Haxhi Qamili, i njohur si person me çrregullime mendore, u zgjodh Komandant i Përgjithshëm. Pas kësaj Qamili nuk pyeste më askënd për veprimet e tij. Persekutonte patriotët dhe u digjte shtëpitë, prandaj filluan ta quanin Haxhi Zjarrmi. Ai shante poshtëronte,

arrestonte, burgoste dhe vriste pa gjyq kundër-shtarët.

Shtypja e kryengritjes

Me nënshkrimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës, në prill 1915, mbyllej shtegu për daljen e Serbisë në Adriatik përmes Shqipërisë së Mesme. Serbia duke ndjerë që po i cenoheshin interesat, vendosi të shtinte në dorë këtë rajon e para dhe të dilte në Durrës. Në këtë mënyrë ajo forconte edhe pozitat e lëkundura të vasalit të saj Esat Pashë Toptanit me të cilin kishte marrëveshje të favorshme. Ushtria serbe e gjendur përballë presionit austro-hungarez, mbasi nuk kishte rrugë tjetër, hartoi plane për t'u tërhequr përmes Shqipërisë dhe për të mbërritur në skelat e Detit Adriatik, nga ku do të largohej me anijet e Aleatëve. Esat Pasha deklaroi se nuk do t'i luftonte forcat serbe gjatë tërheqjes.

Duke parandjerë rrezikun, në fund të majit rebelët pro-turq i dërguan komandantit të ushtrisë serbe në Ohër dy kërkesa, me anë të të cilave pohonin qëndrimin asnjans, kërkonin që të ruheshin marrëdhënie miqësore dhe premtonin se Serbisë nuk do t'i shkaktohej asnjë dëm nga kryengritësit. Por kërkesat e tyre nuk u përfillën.

Më 2 qershor 1915 ushtria serbe sulmoi Shqipërinë nga tre drejtime, në Shqipërinë e Mesme u ndeshën me kryengritësit të cilët i thyen dhe arritën deri në afërsi të Durrësit duke çliruar nga rrethimi disamujor Esat pashë Toptanin. U arrestuan kryetarët e kryengritjes Haxhi Qamili dhe Musa Qazimi, duke i nxjerre përballë gjyqarit Xhelal Bej Zogu, i cili urdhëroi ekzekutimin e tyre. Kështu mori fund Kryengritja në Shqipërinë e Mesme, e cila e çoi Shqipërinë drejt shkatërrimit.

Mizoritë

Gjatë rebelimit "forcat disiplinore" të rebelëve, të cilat drejtoheshin nga myftiu i Tiranës, Musa Qazimi, kryen ekzekutime me qëllim të "spastrimit" të "Skizmatikëve bektashinj". Përveç "Skizmatikëve bektashinj" viktimat të tjera të rebelëve ishin të krishterët, mësuesit, patriotë shqiptarë të cilët përdornin alfabetin latin dhe klerikët myslimanë të cilët mbështesnin kombin shqiptar.

Në listën e të arrestuarve dhe të burgosurve në Berat, në periudhën janar-shkurt 1915, ishin vetëm bejlerët që përkrasin pavarësinë e Shqipërisë. Edhe në Elbasan ishin burgosur e internuar bejlerët e tillë, krahas atdhetarëve me prejardhje të ndryshme shoqërore. Për udhëheqësin e rebelimit, Haxhi Qamilin, bejlerët që donin pavarësinë e Shqipërisë ishin "spiunë të kaurrëve", ata që donin Turqinë ishin të mirë.

Në fazën e dytë të kryengritjes (tetor 1914 - qershor 1915), krerët e rebelimit vranë atdhetarët e njohur, si Ismail Klosin, Hajredin Fratarin, Baki Gjebrean, Hysen Gjirakastrën etj.

Aktivitetet

Forca TOKËSORE



Në kuadër të vizitës në Kosovë, Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, u prit në takim nga Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneralletenant Bashkim Jashari.

Gjithashtu, delegacioni vizitoi Komandën e Forcës Tokësore të FSK në Istog, ku u prit nga zëvendëskomandanti i kësaj njësie, kolonel Hysen Dreshaj.



Gjatë vizitës zyrtare në Kosovë, Komandanti i Forcës Tokësore pritet nga Komandanti i KFOR, gjeneralmajor Ferenc Kajari. Delegacioni shqiptar u prit gjithashtu, nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë, z. Qemal Minxhozi.



Në kampionatin e futbollit, të zhvilluar në rang Force, kampion u shpall batalioni i Forcave Speciale.



Shqipëria, përfaqësohet me Forcat Speciale në stërvitjen "Swift Response-22" e zhvilluar në Maqedoninë e Veriut përkrah 7 vendeve të tjera anëtarë të NATO-s, nën drejtimin e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën.



Nisi stërvitja dislokuese 72-orëshe e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë.

Kjo stërvitje do të zhvillohet në rajonin kombëtar stërvitor të Bizës, me qëllim koordinimin e të gjithë elementëve përbërës të Grup-Batalionit.

